

# Maqedonia e Veriut

*Navigimi i Pakënaqësisë: Perspektivat  
e të Rinjve për Arsim, Punësim dhe Emigrim  
në Maqedoninë e Veriut*

2024



## Autorë

Marija Topuzovska Llatković, Mirjana Borota Popovska, Bojana Naumovska, Nita Starova

## Rreth Studimeve për Rininë të Fondacionit “Friedrich Ebert”

Për çfarë frikësohen apo shpresojnë të rinjtë? Në një botë që po ndryshon me shpejtësi përballë sfidave të krizës klimatike dhe pabarazisë, si dhe me plakjen e shoqërive dhe bjerrjen e demokracisë në shumë rajone, **Studimet për Rininë të FES-it** hulumtojnë mënyrën se si e perceptojnë brezat e rinj zhvillimin e shoqërisë dhe të ardhmen e vet. Qëllimi ynë është të nxitim debatin e informuar mbi pikëpamjet e të rinjve për politikën dhe demokracinë në kontekstin e kushteve dhe vlerave të tyre të jetesës. Kjo përfshin çështje kyç, si: arsimi, punësimi dhe mobiliteti, familja dhe miqtë, si dhe qëndrimet e perceptimet e tyre të përgjithshme. Ne fokusohemi te të rinjtë e moshës 14-29 vjeç, për të kuptuar këndvështrimin e tyre për këto tema thelbësore.

**FES-i** ka kryer studime të shumta për rininë në mbarë botën që nga viti 2009. Në vitin 2024, të rinjtë në Maqedoninë e Veriut u intervistuan në të njëjtën kohë me të rinj në vende të tjera të Europës Juglindore dhe të Europës Qendrore dhe Lindore.

Përmbledhje ekzekutive	4
Fakte kyç	8
<b>1. Hyrje</b>	<b>10</b>
<b>2. Metodologjia</b>	<b>11</b>
<b>3. Karakteristika dhe trende bazore demografike</b>	<b>12</b>
	
 <b>4. Arsimi dhe punësimi</b>	<b>13</b>
<b>5. Mobiliteti dhe migrimi</b>	<b>22</b>
	
 <b>6. Familja dhe planet për të ardhmen</b>	<b>28</b>
<b>7. Vlera, qëndrime dhe perceptime të përgjithshme</b>	<b>31</b>
	
 <b>8. Qëndrime politike dhe pjesëmarrje politike</b>	<b>40</b>
Referenca	54
Fusnota	56
Figurat	57
Për Autorët	58



# Përmbledhje Ekzekutive

## Arsimi dhe punësimi

Në krahasim me studimin e vitit 2018/19, rezultatet aktuale tregojnë një rënie të kënaqësisë me cilësinë e arsimit në vend, ndërkohë që perceptimi i korrupsionit në arsim ka një tendencë rritëse. Ekspozimi afatgjatë i të rinjve ndaj korrupsionit në arsim, ku ata janë dëshmitarë ose pjesëmarrës, mund të çojë që të rinjtë ta perceptojnë korrupsionin si një pjesë normale të jetës dhe një pjesë të pranueshme të procesit arsimor dhe ekziston një rrezik real për ta vazhduar atë sjellje në profesionin e tyre të ardhëm. Sigurisht që kjo gjë ka një ndikim negativ mbi moralin e përgjithshëm dhe nxit dëshirën për të migruar. Krahas këtyre deklaratave, të rinjtë vlerësojnë se faktori më i rëndësishëm në gjetjen e një pune në vendin tonë është «lidhja me njerëzit në pushtet». Kjo sugjeron që të rinjtë janë thellësisht të vetëdijshëm se, përkundër «ekspertizës», një faktor më i madh ndikimi janë lidhjet, miqësitë me njerëzit që kanë pushtet dhe autoritet.

Vlerësimi i përshtatjes së procesit arsimor me kërkesat e tregut të punës tregon se dy të tretat e të anketuarve besojnë se programet shkollore nuk janë të përshtatshme në përgatitjen e të rinjve për t'u punësuar. Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve të punësuar (45%) nuk punojnë në profesionin e tyre, duke treguar një mospërputhje midis sistemit arsimor dhe tregut të punës. Gjysma e tyre përballen me nënpunësim, domethënë punojnë në vende pune ku nuk mund të arrijnë potencialin e tyre dhe ku aftësitë dhe kualifikimet e tyre nënvlerësohen, gjegjësisht vendi i punës kërkon kualifikime më të ulëta.

Është gjithashtu një konstatim i rëndësishëm se koha që të rinjtë u kushtojnë aktiviteteve të lidhura me shkollën është zvogëluar. Një nga arsyet e motivit të ulët për të mësuar është, natyrisht, ndjenja se përpjekja nuk shpërblehet në mënyrë të duhur. Me fjalë të tjera, vetëdijësohen për korrupsionin në arsim. Mund të jetë gjithashtu rezultat i mungesës së metodave interaktive dhe programeve joadekuate, si dhe trajnimit të pamjaftueshëm të mësuesve. Një arsye tjetër është de-fokusimi që të rinjtë kanë nga përdorimi i rrjeteve sociale, sepse një pjesë të madhe të kohës e kalojnë duke e dhënë vëmendjen aty. Sa i përket sektorit të dëshiruar të punësimit, ka pasur një rritje të interesit për të punuar në sektorin privat dhe në organizata ndërkombëtare. Sipas vlerave mesatare, faktori «pagë» është më i rëndësishmi, ndërsa «puna me njerëzit» është më pak e rëndësishme për përzgjedhjen e punës.

## Mobiliteti dhe migrimi

Edhe pse shumica e të rinjve (mbi 90%) nuk kanë qëndruar jashtë vendit për arsye arsimi dhe trajnimi, ekziston një dëshirë e theksuar për migrim jashtë vendit amë, me një mesatare prej  $m=3,25$  në një shkallë nga 1 deri në 5. Gjithsej 67,7% kanë dëshirë për migrim (ose 73,4% pa ata që nuk iu përgjigjën pyetjes), ndërsa 12,4% u përgjigjën se nuk kanë aspak qëllim të tillë. Në krahasim, në Studimin për të rinjtë 2018/2019 gjithsej 62% kanë pasur dëshirë për migrim, mesatarja aritmetike ka qenë  $m=2,9$ , dhe përqindja e atyre që nuk kanë ndërmend të emigrojnë ka qenë 26%, çka tregon një rritje të tendencës për të emigruar nga vendi. Popullsia e re në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka më së shumti dëshirë për migrim në rajon, krahasuar me njëmbëdhjetë vendet e tjera në të cilat është zbatuar hulumtimi.

Arsyet më të rëndësishme për migrim midis të rinjve që kanë një dëshirë të moderuar, të fortë ose shumë të fortë për të emigruar janë si më poshtë: përmirësimi i standardeve të jetesës (30%); paga më e lartë (14%) korrupsioni dhe klientelizmi në vendin tim (13%); mundësi më të mira punësimi (10%); stabiliteti social dhe politik në vendin ku dua të shkoj (8%). Arsyet për migrim janë një kombinim i faktorëve të ndryshëm të natyrës «push» dhe «pull». Gjegjesisht, disa i referohen përmirësimit të situatës financiare dhe perspektivave të lidhura me punën, dhe të tjerë u referohen fenomeneve të caktuara sociale ose karakteristikave socio-politike të shoqërisë maqedonase, të cilat të rinjtë supozojnë se mungojnë ose janë më pozitive në vendin e preferuar ku duan të emigrojnë.

Një konstatim interesant është se profili i të rinjve që kanë tendencën më të madhe për të emigruar nuk përcaktohet nga karakteristikat e zakonshme demografike si mosha dhe statusi socio-ekonomik (shkalla e arsimimit, statusi i punësimit, vendbanimi, gjendja financiare), por më së shumti nga pakënaqësia dhe qëndrimi negativ ndaj fenomeneve të caktuara sociale në vend dhe mbesimi i lartë në institucione.

## Vlera, frikëra dhe perceptime të përgjithshme

Gjëja më e rëndësishme për të rinjtë është të jenë të pavarur, të ushqehen shëndetshëm, të kenë një karrierë të suksesshme, të kenë fëmijë dhe të marrin përgjegjësi. Gjëja më pak e rëndësishme për ta është të jenë politikisht aktivë dhe të veshin gardërobë të markave.

Ata janë optimistë për të ardhmen e tyre personale dhe pesimistë për të ardhmen e shoqërisë maqedonase në 10 vjetët e ardhme. Si problemet më të mëdha potenciale për shtetin në dekadën e ardhme, të rinjtë veçojnë: korrupsionin (63,2%); largimin nga vendi i fuqisë punëtore të kualifikuar (55,3%); cilësinë e shërbimeve publike (shëndetësi, arsim) (51,4%); papunësinë (51,2%).

Kushtet dhe fenomenet që shkaktojnë frikën dhe shqetësimet më të mëdha personale tek të rinjtë janë sistemi i dobët shëndetësor (m=2,63); ndotja dhe ndryshimet klimatike (m=2,43); mungesa e punës (m=2,39); mungesa e një pensioni të mirëfilltë (m=2,37); sëmundja e rëndë (m=2,36).

Mund të vihet re se ekziston një qëndrim konservator në lidhje me abortin dhe homoseksualitetin. Sipas gjetjeve të hulumtimit, të rinjtë tregojnë dhe posedojnë proteksionizëm/qëndrim për të mbrojtur identitetin kulturor nga përzierja me kulturat e tjera dhe tolerancë të ulët, domethënë distancë të lartë shoqërore ndaj personave me orientim tjetër seksual ose përkatësi tjetër etnike/fetare. Megjithëse, në nivel të përgjithshëm, të rinjtë nuk kanë shprehur ndjesi diskriminimi, analizat plotësuese tregojnë se të rinjtë me orientim tjetër seksual përballen njëkohësisht me diskriminim të shumëfishtë.

Diçka pozitive është që të rinjtë janë kundër formave të sjelljes korruptive, gjë që konfirmohet nga gjetjet e tjera të hulumtimit në Studim. Të rinjtë tregojnë eko-ndërgjegjësim të zhvilluar pjesërisht dhe qëndrim pozitiv për çështjet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

## Familja dhe planet për të ardhmen

Shumica e të anketuarve jetojnë me prindërit e tyre (75,2%). Më shumë se gjysma e nënmostrës së të rinjve të cilët kanë thënë se jetojnë me prindërit, gjithashtu janë përgjigjur që për ta kjo është zgjidhja më e thjeshtë dhe më e lehtë (54,5%), ndërsa më shumë se një e treta (37,8%) do të jetonin vetëm, por rrethanat financiare nuk e lejojnë këtë. Një përqindje e lartë prej 45,6% u përgjigjën se kanë raporte të shkëlqyeshme me prindërit, dhe 46,3% thanë se kanë raporte të mira, edhe pse ndonjëherë kanë mendime të ndryshme për çështje të caktuara. Të dhëna të tilla konfirmojnë se dallimet midis brezave nuk përbëjnë pengesë për bashkëjetesën e zgjatur të të rinjve me prindërit.

Shumica e të rinjve (39,4%) u përgjigjën se mund të blejnë disa gjëra më të shtrenjta, por jo aq të shtrenjta sa një makinë apo apartament, 28,7% u përgjigjën se kanë para të mjaftueshme për ushqim, rroba dhe këpucë, por jo të mjaftueshme për gjëra më të shtrenjta (si frigorifer, televizor etj.), 10% u përgjigjën se kanë para të mjaftueshme për faturat bazë dhe ushqim, por jo për rroba dhe këpucë, 9,3% u përgjigjën se mund të blejnë gjithçka që u nevojitet për një standard të mirë jete-se dhe 4,4% u përgjigjën se nuk kanë para të mjaftueshme për faturat bazë dhe ushqim.

Tre faktorët më të rëndësishëm për të rinjtë në zgjedhjen e një partneri janë bindja fetare (m=3,74); prejardhja etnike (m=3,64) dhe niveli i arsimimit (m=3,54). Mesatarisht, të rinjtë planifikojnë të kenë dy fëmijë. Gama e moshës në të cilën ata do të dëshironin të kishin fëmijën e tyre të parë është nga 19 deri në 36 vjeç (me një moshë mesatare m=27,86), me pak ndryshim midis moshës së preferuar të atësisë për meshkujt (m=28,62) dhe amësisë për femrat (m=27,23).

## Qëndrime politike dhe pjesëmarrje politike

Hulumtimet evropiane tregojnë se qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë ndër më pak të interesuarit për politikë, dhe mosinteresi është më i pranishëm kur bëhet fjalë për të rinjtë, siç dëshmohet nga rezultatet e Studimit. Pavarësisht interesit të ulët, të rinjtë tregojnë një shkalë të lartë të pjesëmarrjes politike, veçanërisht kur bëhet fjalë për demokracinë e drejtpërdrejtë, megjithëse format e tjera të pjesëmarrjes janë dukshëm më pak të përfaqësuar. Ajo që mund të shihet në vazhdimësi është se një numër i madh i të rinjve nuk dinë të pozicionohen ideologjikisht, gjë që mund të jetë pjesërisht për shkak të politikave të paqarta (të shpallura dhe të prezantuar) nga partitë politike, të cilat nuk janë në përputhje me përcaktimin e tyre ideologjik.

Arsyeja më e zakonshme pse të rinjtë vendosin të bashkohen me një parti politike është nevoja për të ndikuar në mënyrë që të përmirësohet shoqëria. Funkcioni politik është i pranueshëm për një në pesë të anketuar, por më të hapur për një sfidë të tillë janë meshkujt se femrat. Në përgjithësi, kjo situatë mund të jetë për shkak të besimit të ulët që ekziston te partitë politike, Qeveria dhe Kuvendi, ndërsa sa u përket vajzave të reja, nevojiten fushata afirmative që synojnë inkurajimin dhe përfshirjen më të madhe të tyre në hapësirën politike dhe të përgjithshme publike.

Lidhur me situatën politike në vend, votimin në zgjedhje dhe ndjenjën e afërsisë me partitë politike, vihet re dalja në pah e VMRO-DPMNE-së, gjë e cila në thelb korrespondon me rezultatet e dy cikleve të fundit zgjedhore (2020 dhe 2024). Ajo që devijon nga rezultatet zyrtare është përkrahja për partinë Levica, që është dukshëm më e madhe në mes të popullatës së re.

Besimi në BE mbetet i pandryshuar (nga Studimi për të rinjtë 2018/2019), dhe përveç kësaj të rinjtë besojnë se vlerat që lidhen me standardet e jetesës, shtetin e drejtë dhe mbrojtjen e të drejtave, demokracinë dhe sigurinë janë më të pranishme në BE sesa në vendin tonë. Megjithatë, pavarësisht qëndrimit pozitiv ndaj situatës në BE, qëndrimi i të rinjve në lidhje me pranimin e vendit në BE është i ndarë dhe ka një rritje të euroskepticitizmit në krahasim me hulumtimet e mëparshme. Për herë të parë në zbatimin e studimeve longitudinale për të rinjtë, që nga viti 2013, identifikimi me Evropën është me një vlerë mesatare prej më pak se 3. Po kështu, të rinjtë që nuk e mbështesin kornizën negociuese të propozuar nga Franca, e identifikojnë veten në një masë më të vogël si qytetarë të Evropës ose evropianë.

# Fakte kyç

## Dëshira për të emigruar

68% e të rinjve kanë dëshirë të emigrojnë jashtë vendit. Arsyet më të rëndësishme për migrim midis të rinjve janë përmirësimi i standardit të jetesës (30%), paga më e lartë (14%), korrupsioni dhe klientelizmi në vendin e tyre (13%), mundësi më të mira punësimi (10%) dhe stabiliteti social dhe politik në vendin ku dëshirojnë të emigrojnë (8%).

A duhet të bashkohet Maqedonia e Veriut me BE?

42%  
Po

38%  
Jo

15%  
Nuk e di

61%

e të rinjve janë të pakënaqur me cilësinë e arsimit në vend dhe 69% besojnë se notat mund të 'blijen' në institucionet arsimore.

## Çfarë ka rëndësi për të rinjtë

Gjëja më e rëndësishme për të rinjtë është të jenë të pavarur (m=4,45), të ushqehen shëndetshëm (m=4,22), të kenë një karrierë të suksesshme (m=4,21), të kenë fëmijë (m=4,16) dhe të marrin përgjegjësi (m=4,13). Ata kryesisht dëshirojnë të punojnë në sektorin privat (37%).





## Jo mjaftueshëm të drejta

Të drejtat e pamjaftueshme: Të rinjtë besojnë se të varfrit kanë më pak të drejta (72%), pasuar nga vetë të rinjtë (52%). Përgjigjet dominuese tregojnë se gratë (49%) dhe pakicat etnike (31%) kanë të drejta të mjaftueshme. Për anëtarët e komunitetit LGBT+, përgjigja mbizotëruese është se ata kanë shumë të drejta (28%).

**59%**  
pajtohen se demokracia është një sistem i mirë i qeverisjes.

Shumica e të rinjve jetojnë me prindërit e tyre (75% me nënën dhe 66% me babanë) dhe me vëllezërit e motrat (49%).

## Besim i lartë te Ushtria, besim i ulët te Parlamenti

Besimi më i madh është shprehur ndaj organizatave fetare dhe Ushtrisë. Besimi më i ulët është për Partitë Politike, Qeverinë dhe Kuvendin.

## Djemtë kanë më shumë gjasa të përfshihen në politikë:

Interesi për marrjen e një posti politik është i ulët, megjithatë, dy herë më shumë djem sesa vajza do të pranonin një post politik.

**17%**  
e të rinjve janë të interesuar për politikë, dhe vetëm 7% besojnë se interesat e tyre përfaqësohen në politikë. 39% e të rinjve nuk dinë ose nuk duan të pozicionohen ideologjikisht.

# 1. Hyrje

Që nga viti 2013, çdo pesë vjet, Fondacioni Friedrich Ebert kryen një sondazh nacional për të rinjtë në Republikën e Maqedonisë së Veriut me qëllim të matjes, përshkrimit dhe shpjegimit të qëndrimeve kryesore të popullatës së re maqedonase në lidhje me shoqërinë, politikën, arsimin, punësimin, familjen, fenë dhe integrimin në Bashkimin Evropian.

Sa herë që kryhet sondazhi, përdoret e njëjta metodologji në të gjitha vendet e rajonit, gjë që siguron dhe rezulton në analiza krahasuese plotëse. Rezultatet nga hulumtimet e kaluara kanë ngjallur interes të madh në Maqedoninë e Veriut dhe gjatë viteve të kaluara u shfrytëzuan si bazë për krijimin e propozimeve të caktuara për politika dhe projekte.

Këtë vit, Friedrich-Ebert-Stiftung përsëri e realizoi këtë sondazh. Përmes zbatimit të njëkohshëm të sondazhit për të rinjtë në secilin nga 12 vendet e rajonit të Evropës Juglindore në vitin 2024, arritëm të mblidhnim, analizonim dhe interpretonim të dhëna mbi perceptimin, pritshmëritë, qëndrimet e të rinjve dhe raportin e tyre ndaj ngjarjeve aktuale në jetën e përditshme. Studimi aktual për të rinjtë ofron njohuri të thella për të rinjtë e vendit, dëshirat, shpresat dhe frikën e tyre, dhe në të njëjtën kohë ofron një pasqyrë krahasuese me të dhënat nga studimet e mëparshme nga 2013 dhe 2018, duke ofruar një analizë unike gjithëpërfshirëse të asaj që «sjell» ky brez i ri.

Popullsia e re e përfshirë në anketë është e moshës 14–29 vjeç dhe aktualisht përbëhet nga dy grupe gjeneratash, të njohura si Gjenerata Y (e lindur midis viteve 1981 dhe 2000) dhe Gjenerata Z (e lindur pas vitit 2000). Këta të rinj janë dëshmitarë të disa ndryshimeve dinamike në nivel global: pandemia dhe lufta në Ukrainë, kriza energjetike, ndryshimi i klimës, zhvillimi i shpejtë teknologjik, që ka rezultuar në transformimin dixhital të të gjitha fushave të jetës, lëvizjet politike dhe paqëndrueshmëria politike e shkaktuar nga sulmet terroriste, luftërat populiste dhe kriza ekonomike. Në të njëjtën kohë ata janë prekur në mënyrë direkte dhe indirekte nga trazimet politike dhe sociale në vend: kriza politike, afera të shumta dhe skandale korrupsioni, zhgënjim nga proceset e integritimit evropian në vend, që kohët e fundit kanë çuar në ndryshimin e qeverisë.

Sipas rezultateve të anketës, të rinjtë nga Maqedonia pa dyshim që i ndajnë karakteristikat e përgjithshme, vlerat, dëshirat dhe frikën e brezave Y dhe Z me bashkëmoshatarët e tyre në rajon dhe botë, megjithëse për aspekte të caktuara vihet re ndikimi i kontekstit nacional.

Dëshira për të migruar dhe për t'u larguar nga vendi në kërkim të një standardi më të mirë jete-se ekziston ende tek të rinjtë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ata jetojnë me prindërit e tyre dhe synojnë të bëhen të pavarur. Interesi i tyre për proceset politike është ende i një niveli të ulët, pasi ata mendojnë se nuk janë të përfaqësuar sa duhet në politikë. Ekziston pakënaqësi nga sistemi arsimor dhe përshtatja e programeve në tregun e punës - rezultate shqetësuese që tregojnë një sërë sfidash aktuale me të cilat duhet të përballen politikëbërësit dhe vendimmarrësit, por edhe vetë të rinjtë, në mënyrë që të ndikohet mbi këto tendenca negative.

Studimi tregon për sfidat dhe masat urgjente që duhet të ndërmerren për të përmirësuar gjendjen e të rinjve në shoqërinë maqedonase, pasi jemi të vetëdijshëm se ata janë udhëheqësit e ardhshëm, politikanët, edukatorët, inovatorët, punëdhënësit, qytetarët e BE-së dhe botës. E ardhmja është në duart e tyre dhe ata duhet të kenë potencialin për të ndryshuar dhe përmirësuar demokracinë dhe ekonominë në vend.

**Dr. Peter Hurelbrink,**  
Drejtor i Fondacionit Friedrich Ebert  
në Republikën e Maqedonisë së Veriut

**Nita Starova,**  
Menaxhere programi në Fondacionin Friedrich  
Ebert dhe hulumtuese në kuadër të Studimit

# 2. Metodologjia

Të gjitha aktivitetet hulumtuese në terren kryhen nga Ipsos, në bashkëpunim të ngushtë me Fondacionin Friedrich Ebert (qendra hulumtuese në Vjenë dhe zyrat nacionale). Hulumtimi u realizua në periudhën nga 09.02.2024 deri më 25.03.2024, njëkohësisht në 12 vende të rajonit.

Pyetësi i krijua nga Fondacioni Friedrich Ebert, ndërsa u përkthye dhe u pilotua nga ekipi i Ipsos. Në një proces konsultimi me ekipet nacionale të kërkimit, janë shtuar deri në maksimum 10 pyetje specifike për vendin.

Mostra e hulumtimit përbëhet nga përfaqësues të popullsisë së re, rezidente në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të moshës 14 deri në 29 vjeç. Mostra është hartuar me kuota: sipas gjinisë, moshës, rajoneve statistikore dhe gjuhës së anketës (maqedonisht dhe shqip), si dhe një kuotë të butë plotësuese për nivelin e arsimit. Madhësia e mostrës është  $n=504$  subjekte.

Të dhënat u mblodhën me një qasje të kombinuar metodologjike, përkatësisht 40% përmes intervistave online të asistuar nga kompjuteri (CAWI) përmes panelit online të Ipsos dhe 60% përmes sondazheve telefonike të asistuar nga kompjuteri (CATI).

Ndarja e intervistave offline dhe online bazohet në rekomandimet lokale dhe studimet e mëparshme të të njëjtit grup të synuar/të ngjashëm. Për subjektet e mitura (14–17) është kërkuar pëlqimi i prindit/kujdestarit.

Kufizimet e hulumtimit:

- për anketën CAWI, është e domosdoshme qasja në internet dhe përdor persona paraprakisht të regjistruar në panelin online;
- për anketën CATI është e domosdoshme lidhja telefonike;
- sondazhi CAPI ose F2F (ballë për ballë) nuk është përdorur, gjë që do të ofronte një mundësi për të anketuarit që të marrin më tej udhëzime nga të intervistuarit rreth pyetjeve të caktuara, si dhe të përgjigjen plotësisht në mënyrë të pavarur për pyetje specifike/të ndjeshme;
- gabim marginal i mostrës  $\pm 4,4$ .

Të dhënat janë anonime dhe privatësia mbrohet sipas rregullores GDPR/EU Regulation 2016/679.

Autorët e studimit janë përgjegjës për analizimin e të dhënave dhe hartimin e raportit hulumtues. Analiza është sasiore, të dhënat analizohen në SPSS (Statistical Package for the Social Sciences), në nivel përshkrues dhe të avancuar – inferencial, duke përdorur procedurat statistikore të mëposhtme: shpërndarja e përgjithshme, kros-tabulimi, analiza e vlerave mesatare, korrelacioni bivariant, testet joparametrike për të kontrolluar rëndësinë statistikore.

Studimi përmban rishikimin dhe analizën e literaturës të të dhënave dytësore. Uniformiteti i metodologjisë dhe karakteri longitudinal mundësojnë gjithashtu analiza krahasuese, në raport me studimet e mëparshme për të rinjtë të viteve 2013 dhe 2018/2019, si dhe në raport me rezultatet e studimeve kërkimore të Fondacionit Friedrich Ebert të kryera në vende të tjera të rajonit.

Rezultatet e hulumtimit paraqiten përmes një ekрани tabelar dhe grafik, me interpretim tekstual nga autorët.



# 3. Karakteristika dhe trende bazore demografike

Sipas të dhënave zyrtare të Entit Shtetëror të Statistikave, nga regjistrimi i fundit i vitit 2021, në Republikën e Maqedonisë së Veriut jetojnë gjithsej 326.733 të rinj ose 17,8 % e popullsisë së përgjithshme prej 1.836.713 banorësh, prej të cilëve 51,2 % janë meshkuj dhe 48,8 % femra. Më poshtë paraqiten detajet e ndarjes sipas gjinisë dhe grupmoshës. Në vitin 2023, shkalla e papunësisë në mesin e popullsisë së re (15–29) ishte 25,4 %, me një normë të përgjithshme të papunësisë prej 13 % në vend. Përqindja e të rinjve<sup>1</sup> NEET (15–29) ishte 22,8 % në vitin 2022 (Stojçeska, Dukovska, Topuzovska Llatkoviç, 2024).

Fig. 1 Shpërndarja e popullsisë së re sipas gjinisë dhe moshës

Burimi: Enti shtetëror për statistikë, MakStat

	Mosha	Popullsia
Burra	15–19	53.405
	20–24	54.525
	25–29	59.354
Gra	15–19	50.630
	20–24	52.028
	25–29	56.791



## Përshkrimi i mostrës

Mostra përbëhej nga gjithsej n=504 subjekte, ku 42,1 % ishin meshkuj dhe 57,9 % femra; 25 % i përkisnin grupmoshës 14–18 vjeç, 39 % grupmoshës 19–24 vjeç dhe 36 % grupmoshës 25–29 vjeç.

Sipas vendbanimit, 60,2 % janë nga mjedisi urban (qyteti) dhe 39,8 % nga mjedisi rural (fshati). Sipas përkatësisë së rajoneve statistikore, një e treta e të anketuarve (33 %) janë nga rajoni i Shkupit, 15,5 % nga Pollogu, 10,6 % nga rajoni i Pellagonisë, 10,1 % nga rajoni jugperëndimor, 9 % nga rajoni verilindor, 7,4 % nga rajoni juglindor, 7,3 % nga rajoni lindor dhe 7 % nga rajoni i Vardarit.

Sondazhi në gjuhën maqedonase u plotësua nga 78,4 % e të anketuarve, ndërsa 21,6 % e plotësuan atë në gjuhën shqipe.

Fig. 2 Përshkrimi i mostrës (in %)

Grupmosha → 1–18	25,0
19–24	39,0
25–29	36,0
Gjinia → Meshkuj	42,1
Femra	57,9
Vendbanimi → Fshat	39,8
Qytet	60,2
Rajoni → i Vardarit	7,0
Lindor	7,3
Jugperëndimor	10,1
Juglindor	7,4
i Pellagonisë	10,6
i Pollogut	15,5
Verilindor	9,0
i Shkupit	33,0

# 4. Arsimi dhe punësimi

Sipas të dhënave zyrtare nga Enti shtetëror për statistikë (ESHS) me të dhëna nga viti 2022/2023 (ESHS, 2024) në vend ka 966 shkolla fillore të rregullta me 185.099 nxënës, 129 shkolla të mesme të rregullta me 69.227 nxënës. Maqedonia ka 14 universitete dhe 5 shkolla profesionale me 53.821 studentë të regjistruar. Numri i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm në Maqedoninë e Veriut ka tendencë të uljes nga viti 2015 deri më sot.<sup>2</sup> Kjo rënie vjen për shkak të ndryshimeve të shumta demografike, emigracionit, si dhe faktorëve të tjerë socialë dhe ekonomikë.

Që nga pavarësia e deri më sot, sistemi arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut po përballlet me sfida serioze dhe reforma të vazhdueshme. Si pozitive mund të dallohen: rritja e disponueshmërisë së arsimit fillor dhe të mesëm, si dhe përpjekjet për të zbatuar reforma të shumta për të përmirësuar cilësinë e arsimit, që përfshin futjen e kurrikulave të reja dhe trajnimeve për mësuesit. Megjithatë, rezultatet e PISA 2018 (OECD, 2019, PISA results 2018) tregojnë se 65 % e nxënësve janë nën nivelin bazë të leximit, 61 % në matematikë dhe 54 % në shkencë, gjë që është dukshëm nën mesataren e OECD-së. Këto rezultate tregojnë se një numër i konsiderueshëm i nxënësve nuk arrijnë nivelet themelore të shkrim-leximit gjuhëor dhe matematikor.




Sipas një raporti të Bankës Botërore (BB) për përmirësimin e efikasitetit të financimit të arsimit në vend, janë identifikuar pabarazi të konsiderueshme në shpërndarjen e burimeve midis zonave urbane dhe rurale. Shkollat rurale përballen me mungesë të infrastrukturës moderne dhe materialeve mësimore. Është vënë re nevoja e përmirësimit të cilësisë së stafit mësimdhënës duke përmirësuar trajnimet dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Financimi i arsimit si përqindje e PBB-së është nën mesataren e BE-së, gjë që kufizon potencialin për përmirësimin e kushteve shkollore. Në arsimin fillor dhe të mesëm, ekziston një pabarazi mes suksesit të nxënësve dhe qëndrimit në procesin arsimor nëpër rajone dhe grupe shoqërore të ndryshme (How to Improve the Efficiency of Education Spending in North Macedonia, 2023).

Sipas një raporti të Komisionit Evropian për Arsimin, Rininë dhe Sportin (Education and well-being 2021), numri i njerëzve që përfundojnë arsimin e lartë tregon shkallën më të lartë të konvergencës, duke u rritur nga 40 % në 65 % të mesatares së BE-së (2013–2022). Megjithatë, normat e pjesëmarrjes në aktivitetet e të mësuarit gjatë gjithë jetës janë ende dukshëm më të ulëta se nivelet e BE-së. Çështja e shpenzimeve të ulëta të Maqedonisë së Veriut për hulumtime dhe zhvillim mbetet një sfidë e vazhdueshme për të nxitur aftësi për inovacione. Në vitin 2020, shpenzimet për hulumtime ishin vetëm 0,37 % e PBB-së nacionale, që është dukshëm nën mesataren e BE-së (2,32 %).

## Qëndrimi mbi cilësinë e arsimit

Sa i përket cilësisë së arsimit, ai u vlerësua me një mesatare prej  $m=2,1$ , që është 0,5 pikë më keq se studimi për të rinjtë i vitit 2018/2019 (Studimi për të rinjtë 2018/2019), ku cilësia e arsimit u vlerësua me një mesatare prej  $m=2,6$  në një shkallë prej 1 – nuk jam aspak i kënaqur, 5 – jam shumë i kënaqur, 60,6 % janë në shkallën e pakënaqësisë krahasuar me studimin në 2018/19 kur 43,6 % ishin të pakënaqur.

Fig. 3 **Kënaqësia me cilësinë e arsimit mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)**

Përqindja e atyre që u deklaruan të kënaqur gjithashtu u zvogëlua dhe ishte 9,1% për dallim nga rezultatet në 2018/19 kur përqindja e të kënaqurve ishte 20,8%. Nuk ka asnjë lidhje të rëndësishme midis faktit nëse dikush jeton në një mjedis rural ose urban dhe kënaqësisë së tyre me cilësinë e arsimit.

## Korrupsioni

Një tregues i cilësisë së arsimit mund të jetë edhe perceptimi nëse notat merren në bazë të njohurive/përprjekjeve/meritës, ose në bazë të lidhjeve, miqësive, ryshfetit. Në një shkallë nga 1 (nuk pajtohem) deri në 5 (plotësisht pajtohem) mesatarja është  $m=3,8$ , gjegjësisht të anketuarit kryesisht pajtohen se në disa raste notat dhe provimet blihen në institucionet arsimore në vend. Të rinjtë nga zonat urbane besojnë më tepër (72,9%) se ka blerje të notave sesa të rinjtë në zonat rurale 62% ( $\chi^2=10.622$ ,  $p<0,05$  .031).

Ekspozimi afatgjatë i të rinjve ndaj korrupsionit në arsim, ku ata janë dëshmitarë apo pjesëmarrës në proces, mund të çojë që të rinjtë ta perceptojnë korrupsionin si një pjesë normale të jetës dhe një pjesë të pranueshme të procesit arsimor dhe ekziston një rrezik real për ta vazhduar atë sjellje në profesionin e ardhëm. Ekziston një rrezik real që ata ta transferojnë këtë sjellje në të ardhmen në jetën e tyre, sidomos në profesionin e tyre. Kjo mund të çojë në vazhdimin dhe rritjen e korrupsionit në shoqëri. Gjithashtu mund të ndikojë besimin në institucionet publike dhe zhvillimin e përgjithshëm të vendit. Sigurisht që ka kjo gjë ka dhe një ndikim negativ në moralin e përgjithshëm dhe nxit dëshirën për të emigruar. Testi Hi-katror ( $\chi^2=54.579$ ,  $p<0,01$ ) tregon se ekziston një marrëdhënie e rëndësishme statistikore midis perceptimit të korrupsionit në arsim dhe dëshirës për emigrim. Për shembull, ata që pajtohen plotësisht se ka korrupsion në arsim, kanë një dëshirë shumë të fortë për emigrim (62,4%). Të rinjtë janë të vetëdijshëm për efektet e korrupsionit dhe i veçojnë ato si problemin më të madh të shtetit për dekadën e ardhme (63,2%), e më pas si probleme të dekadës i veçojnë edhe largimin e kadrove cilësore (55,3%), zvogëlimin e cilësisë së shërbimeve publike (51,4%) dhe papunësinë (51,2%).

## 69% e të rinjve besojnë se notat mund të blihen


Nëse i krahasojmë vlerat e përmbledhura të pajtimit dhe mospajtimit nga ky vit dhe nga studimet e kaluara (2013, 2018/2019), do të shohim se perceptimi për blerjen e notave në dekadën e fundit është në rritje në shoqërinë tonë. Në vitin 2013, 26% e të rinjve mendonin se ka blerje notash, në 2018/2019 54,9% ishin të këtij mendimi, ndërsa këtë vit 68,8%.

## Shfrytëzimi i kohës

Të rinjtë studiojnë mesatarisht rreth 2 orë në ditë. Testi Hi-katror ( $\chi^2= 24.483$ ,  $p<0,01$ ) tregoi se të anketuarit që kanë plotësuar pyetësin në maqedonisht kalojnë më shumë kohë në aktivitete të lidhura me shkollën, veçanërisht në kategoritë «2–3 orë» dhe «3–5 orë». Të rinjtë shqipfolës më së shumti përgjigjen me kategoritë «15–30 minuta» dhe «1–2 orë», jo në kategoritë me periudha më të gjata kohore.

Fig. 4 Perceptimi i korrupsionit në arsim mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)

Përgjigjet 'Pajtohem', 'Në mes' dhe 'Nuk pajtohem' në deklaratën 'Në disa raste, notat dhe provimet "blihen"'



Kjo sugjeron që të rinjtë që flasin maqedonisht shpenzojnë më shumë kohë në këto aktivitete në krahasim me ata që flasin shqip. Nuk është shfaqur ndonjë dallim i rëndësishëm statistikor në orët e dedikuara për mësim në raport me gjininë, mjedisin rural ose urban, shkollimin e prindërve, si dhe gjendjen financiare të familjes.

Duke vëzhguar grafikun krahasues, që është krijuar në bazë të grupimit të përgjigjeve nga ky vit dhe duke i krahasuar ato me të dhënat e studimeve të kaluara, mund të konkludojmë se koha e kaluar në aktivitetet e lidhura me shkollën ka ndryshuar ndjeshëm në tre periudhat e vëzhguara. Në vitin 2013, shumica e studentëve kanë kaluar 3 orë, ndërsa në 2018/19, pjesa më e madhe kanë kaluar 1–3 orë, kurse në vitin 2024 ka një rritje të dukshme të nxënësve të cilët kalojnë 0–1 orë.

Rezultatet tregojnë një motivim të zvogëluar dhe interes të ulët për të mësuar, gjë që mund të jetë rezultat i mungesës së metodave interaktive dhe programeve të papërshtatshme, si mungesa e trajnimit të arsimtarëve. Ky konkluzion është në përputhje me raportet e BB-së dhe rezultatet e testit PISA.

Gjithashtu duhet të merret parasysh ndikimi i teknologjisë dhe përdorimi i rrjeteve sociale, të cilat mund të përfaqësojnë një lloj të caktuar të humbjes së përqendrimit dhe zvogëlimit të vëmendjes. Rezultatet e marra konfirmojnë këtë mendim, të rinjtë që janë pjesëmarrës aktivë në procesin arsimor kalojnë më shumë kohë në rrjetet sociale (m=5,58) ose rreth 3 orë, më pas ndjekin aktivitete që lidhen me arsimin (m=4,95) ose rreth 2 orë; më pas vjen leximi i gazetave në internet dhe platformave të informacionit (m=3,2) dhe kryerja e aktiviteteve që lidhen me punën e paguar (m=3,17) ose rreth 30 minuta. Teknologjia e argëtimit, si videolojërat, mediat sociale dhe platformat e streamingut, mund të zvogëlojnë kohën që nxënësit shpenzojnë në aktivitetet shkollore dhe të ulin përqendrimin.

## Arsimi dhe punësueshmëria

Bashkangjitur me notën e cilësisë së procesit arsimor është dhe nota për përshtatjen e procesit arsimor me botën e punës.

Fig. 5 **Orët e kaluara në të nxënit mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)**

*Aproximativ, sa kohë shpenzoni në aktivitetet e mëposhtme online gjatë një dite pune mesatare?*

Pjesa e përgjigjeve nga ata që treguan, 'Unë jam angazhuar në aktivitete që lidhen me arsimin tim.'





Fig. 6 **Adaptimi i kurikulave arsimore në botën e punës – mendimet mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)**



Termi punësueshmëri do të thotë *gatishmëri për punë*, për sa i përket zotërimit të aftësive, njohurive, qëndrimit dhe të kuptuarit të industrisë, gjë që do t'i lejojë studentët të cilët kanë përfunduar studimet, të kontribuojnë në mënyrë produktive në qëllimet organizative shumë shpejt pas punësimit të tyre (Mason, 2009).

Dy të tretat e të anketuarve besojnë se programet shkollore nuk janë të përshtatura për kërkesat e punës (68,14 %), ndërsa (18,9 %) besojnë se ato janë të përshtatura. Sa i përket rezultateve të vitit 2018/19, nuk ka pasur asnjë ndryshim në qëndrime.

Nga analiza e dokumenteve, hulumtimeve dhe studimeve, mund të dallohen problemet kryesore që lidhen me pozicionin e të rinjve në tregun e punës: kalimi i vështirë nga shkolla në punë; mungesa e praktikës për punë në kushte reale; disproporcioni midis përvojës arsimore të fituar dhe nevojave reale të tregut të punës; pranimiti i punës së padeklaruar (punë në të zezë), niveli i ulët i pagave.

Për faktin që të rinjtë kanë vështirësi në gjetjen e punës flasin dhe të dhënat nga ESHS (Baza Makstat, popullsia e aftë për punë) Punësimi më i ulët evidentohet në grupmoshën 15–24 vjeç dhe është 19,9 %.



Punësimi më i lartë evidentohet në grupmoshat 25–49 vjeç dhe është 70,8 %, që është tipike për personat në moshë pune me përvojë të akumuluar.

Në mostrën tonë të grupmoshës 14–19, 14,5 %, e të rinjve kërkojnë punë në mënyrë aktive, ndërsa në grupmoshën e të rriturve 19–24 kjo përqindje është 25 %. Punë të përhershme me orar të plotë kanë 2,4 % në grupmoshën 14–18 vjeç dhe 9,4 % në grupmoshën 19–24 vjeç. Në grupmoshën 25–29 vjeç, punë të përhershme me orar të plotë kanë 73 % e të rinjve.

Nga ata që janë të punësuar, 30,3 % punojnë në profesionin e tyre dhe 14 % afër profesionit të tyre. Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve të punësuar (45 %) nuk punojnë në fushën e profesionit të tyre, gjë e cila tregon një mospërputhje midis sistemit arsimor dhe tregut të punës. Për të rinjtë që punojnë në profesionin e tyre, në 73,4 % të rasteve kërkesat arsimore në vendin e punës janë në përputhje me nivelin e tyre të arsimit formal. Siç edhe pritet për ata që nuk punojnë në fushën e profesionit të tyre (45,3 %), në pothuajse gjysmën e rasteve (46 %), vendi i punës kërkon një nivel më të ulët të arsimit formal sesa ai që kanë, tregues që niveli i fituar i arsimit nënvlerësohet. Kjo do të thotë, gjysma e të rinjve të punësuar përballen me fenomenin e nënpunësimit – domethënë, ata punojnë në një vend pune që nuk është në përputhje me aftësitë, kualifikimet dhe aspiratat që ata posedojnë dhe vendi i punës nuk i lejon punonjësit të arrijnë potencialin e tyre.

## Vendi i dëshiruar i punës

Të rinjtë më së shumti dëshirojnë të punojnë në sektorin privat. Dëshira për të punuar në sektorin privat ka treguar një rritje të lehtë në vitin 2024 (36,6 %), në vitin 2018 ishte (34 %), dhe në vitin 2013 ishte (29,6 %). Një ndryshim i tillë mund të jetë për shkak të rritjes së pagave në sektorin privat dhe rritjes së kërkesës për punëtorë në këtë sektor, si dhe për shkak të mundësive të zhvillimit të karrierës që ofron (veçanërisht në industrinë e IT). Krahasuar me vitet e tjera, përqindja e të anketuarve të cilët duan të punojnë në sektorin publik në 2024 është 30 % dhe është dukshëm i zvogëluar në raport me ata të cilët donin të punonin në 2018 (45 %) dhe në 2013 (39 %). Interesi për punë në organizata ndërkombëtare është rritur ndër vite (2024: 16,3 %, 2018: 10,8 % dhe 2013: 13 %) dhe tregon për faktin që të rinjtë kanë një nevojë më të madhe për përvojë globale dhe karrierë ndërkombëtare.

Testi Hi-katror ( $\chi^2= 21.102$ ,  $p<0,01$ ), tregon dallime në preferencat për sektorin e punësimit midis subjekteve maqedonishtfolëse dhe atyre shqipfolëse. Një përqindje më e lartë e të anketuarve që përfunduan sondazhin në gjuhën shqipe (35,5 %) preferojnë të punojnë në sektorin publik krahasuar me të anketuarit që përfunduan sondazhin në gjuhën maqedonase (27,9 %), ndërsa një përqindje më e lartë e atyre që flasin maqedonisht (39 %) preferojnë të punojnë në sektorin privat krahasuar me ata që flasin shqip (22,6 %).


Fig. 7 Përshatja e arsimit dhe punësimit mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)

Analiza e Crosstabulation

	Kërkon një nivel më të lartë arsimit krahasuar me arsimin që ju keni	Përputhet me nivelin e arsimit që ju keni	Kërkon një nivel më të ulët arsimit krahasuar me arsimin që ju keni
Po, punoj në profesionin tim	15,6	73,4	10,9
Punoj në një punë të përafërt me profesionin tim	13,8	51,7	34,5
Jo, nuk punoj në profesionin tim	16,1	37,9	46,0
Nuk jam trajnuar për asnjë profesion	28,6	35,7	35,7

Fig. 8 **Sektori i preferuar i punësimit mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)**

Në cilin nga sektorët e mëposhtëm do të preferonit të punonit më shumë?



Një përqindje dukshëm më e lartë e të anketuarve që përfunduan sondazhin në gjuhën shqipe (25,8%) preferojnë të punojnë në organizata ndërkombëtare krahasuar me ata që e përfunduan atë në gjuhën maqedonase (12,7%).

## Faktorët për zgjedhje të punës

Në zgjedhjen e një punë të caktuar, të rinjtë veçojnë tre faktorët më të rëndësishëm për ta nga tetë faktorët e dhënë: së pari «paga»; së dyti «puna e sigurt»; dhe së treti «mjaftueshëm kohë e lirë, krahas punës». Më tej në vend të katërt është «ndjesia se po arrijnë diçka»; në të pestin «mundësitë e karrierës»; në të gjashtin «të punosh me kolegët që të pëlqejnë»; në vendin e shtatë «të bësh diçka domethënëse për shoqërinë» dhe në vendin e tetë «të punosh me njerëzit».

Është evdientuar korrelacion i rëndësishëm me statusin socio-ekonomik, gjegjësisht me të ardhurat e familjes. Mund të konkludohet se ka një dallim midis atyre me të ardhura më të larta dhe atyre me më të ulëta. Për ata që vijnë nga familjet me të ardhura më të larta, faktorët më të rëndësishëm janë: «mundësitë e karrierës», «ndjenja se po arrijnë diçka», «të bërit të diçkaje kuptimplotë për shoqërinë», «kohë të lirë të mjaftueshme, përveç punës», krahasuar me ata që vijnë nga familjet me të ardhura më të ulëta. Për gjininë femërore më e rëndësishme është paga, një vend pune i sigurt dhe ndjenja që po arrijnë diçka, krahasuar me gjininë mashkullore.

Duke u nisur nga teoria për dallimin e gjeneratave dhe vlerave të punës (Eisner, 2005; Twenge et al. 2010) gjenerata e Gjenerata Y dhe Gjenerata Z janë gjithmonë e më të pranishme në tregun e punës dhe në dekadën e ardhme do ta mbizotërojnë atë. Këto rezultate ku «paga» vjen e para tregojnë preferencat e tyre, domethënë që këto gjenerata janë të përqendruara në stabilitetin financiar dhe punën e sigurt. Kjo preferencë është ndoshta për shkak të presionit financiar që këto breza ndiejnë si rezultat i ndryshimeve të shpejta në ekonomi dhe politikë dhe paqëndrueshmërisë së ekonomive dhe shteteve. Në të njëjtën kohë, fakti që «puna me njerëzit» është faktori më pak i rëndësishëm mund të tregojë se brezat e rinj, ndonëse vlerësojnë punën ekipore dhe marrëdhëniet e mira me kolegët, u japin rëndësi më të madhe faktorëve që ndikojnë drejtpërdrejt në stabilitetin e tyre financiar.

## Faktorët për gjetjen e një pune

Si faktor të rëndësishëm në gjetjen e punës në shtetin tonë, të rinjtë vlerësojnë se është «lidhja me njerëzit që janë në pushtet». Kjo sugjeron që të rinjtë janë thellësisht të vetëdijshëm se, përëndër «ekspertizës», një faktor më i madh ndikimi janë lidhjet, miqësitë me njerëzit që kanë fuqi dhe autoritet. Megjithatë, «ekspertiza» është në vend të dytë, që tregon se kualifikimet dhe aftësitë vlerësohen. Së treti, si faktor ndikues veçohet «anëtarësimi në një parti politike», «përvoja nga jashtë».

Fig. 9 Renditja e faktorëve të rëndësishëm për zgjedhjen e punës

Rangu	Faktorët	Vlera mesatare (m)
1	Të ardhurat/paga	4,6
2	Vend i sigurt pune	4,4
3	Të kesh kohë të lirë të mjaftueshme përveç punës	4,4
4	Ndjesia se po arrin diçka	4,4
5	Mundësi karriere	4,3
6	Të punosh me kolegë që të pëlqejnë	4,1
7	Mundësia për të bërë diçka kuptimplotë për shoqërinë	4,0
8	Puna me njerëzit	3,8

Fig. 10 Renditja e faktorëve për gjetjen e punës

Rangu	Faktorët	Vlera mesatare (m)
1	Lidhja me njerëzit në pushtet	3,7
2	Ekspertiza	3,5
3	Anëtarësimi në parti politike	3,5
4	Përvojë nga jashtë	2,9

## Vullnetarizmi

Vullnetarizmi i të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut duhet të luajë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e një shoqërie demokratike dhe ndërtimin e qytetarëve aktivë dhe të përgjegjshëm. Me aktivitete vullnetare, të rinjtë do të kenë mundësinë të fitojnë aftësi të reja, të përmirësojnë përvojën e tyre profesionale dhe të kontribuojnë në promovimin e shoqërisë. Vullnetarizmi gjithashtu u mëson të rinjve rëndësinë e solidaritetit, altruizmit dhe përgjegjësisë sociale. Këto aktivitete, jo vetëm që pasurojnë zhvillimin e tyre personal dhe profesional, por gjithashtu ndihmojnë në krijimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe më të barabartë.

Vullnetarizmi është të veprosh në bazë të zgjedhjes tënde të lirë, duke investuar kohën tënde, dhe qëllimi është të kontribuosh me përmbajtje dhe vlera të reja në jetën e njerëzve të tjerë, pa pritur përfitime materiale, domethënë mund që nuk paguhet (Wilson, 2000).; Puljiz i sur., 2005).

Niveli i përfshirjes së të rinjve në aktivitetet vullnetare është 19,7% dhe është në të njëjtin nivel me vitin 2018 (20%), për dallim nga viti 2013 ku kjo përqindje ishte vetëm 12,8%.

Kemi të bëjmë me një nivel shumë të ulët të përfshirjes në aktivitete vullnetare/të papaguara. Për sa i përket gjinisë, gjuhës, grupmoshave, vendbanimit dhe nivelit të arsimit, nuk është evidentuar ndonjë dallim i rëndësishëm. Duke pasur parasysh se vullnetarizmi është një lloj përgatitjeje për tregun e punës, sepse lejon të mësuarit dhe fitimin e përvojës dhe aftësive të reja, veçanërisht kur flasim për punën në ekip, komunikimin, iniciativën, vendimmarrjen, ky nivel i ulët i aktiviteteve vullnetare vetëm sa u mohon të rinjve mundësinë për t'u përgatitur më mirë për punë dhe jetë.

## Vëzhgime përmbyllëse

**1.** Cilësia e arsimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut vlerësohet me një vlerë mesatare prej  $m=2,1$ , gjë që paraqet një përkeqësim të ndjeshëm prej 0,5 pikëve krahasuar me studimin 2018/2019.

**2.** Perceptimi për korrupsionin në arsim në dekadën e fundit në shoqërinë tonë është gjithashtu në rritje. Në vitin 2013, 26 % e të rinjve mendonin se ka blerje notash, në vitin 2018/2019 kjo përqindje ishte 54,9 %, ndërsa në vitin 2024 është 68,8 %.

**3.** Niveli i kënaqësisë nga arsimi dhe niveli i korrupsionit në arsim janë dy faktorë të cilët janë shumë të lidhur mes vete. Niveli i lartë i korrupsionit në sistemin arsimor zakonisht rezulton me nivel të ulët të kënaqësisë nga arsimi, sepse studentët dhe nxënësit ndjejnë që procesi arsimor nuk është i drejtë dhe se notat dhe diplomat nuk reflektojnë vlerat dhe meritat e vërteta.

**4.** Niveli i lartë i korrupsionit mund të ketë efekte negative mbi nxitjen për të mësuar dhe për t'u përpjekur, besimi i tyre ndaj institucioneve dhe mobiliteti i tyre shoqëror e nxisin emigrimin e talenteve të reja, gjë që në një periudhë më afatgjatë, rezulton me erozionin e kapitalit shoqëror. Përveç këtyre pretendimeve, të rinjtë vlerësojnë se faktori më i rëndësishëm në gjetjen e një pune në vendin tonë është «lidhja me njerëzit në pushtet». Kjo sugjeron që të rinjtë janë thellësisht të vetëdijshëm se, përkundër «ekspertizës», një faktor më i madh ndikimi janë lidhjet, miqësitë me njerëzit që kanë fuqi dhe autoritet. Është gjetur një lidhje e rëndësishme statistikore midis perceptimit të korrupsionit në arsim dhe dëshirës për të emigruar. Për shembull, ata që janë plotësisht dakord se ka korrupsion në arsim, kanë një dëshirë shumë të fortë për të emigruar. Si pasojë, lufta kundër korrupsionit është thelbësore për të siguruar një sistem arsimor të drejtë dhe cilësor që do të motivojë rininë dhe do të kontribuojë në përparimin social.

**5.** Gjithashtu, një konstatim i rëndësishëm është se koha që të rinjtë u kushtojnë aktiviteteve të lidhura me shkollën është zvogëluar. Një nga arsytet e motivit të ulët për të mësuar është natyrisht ndjenja se përpjekja nuk shpërblehet në mënyrë adekuate, pra vetëdijësohen për korrupsionin në arsim. Një arsye tjetër është defokusimi që kanë nga përdorimi i mediave sociale, pasi pjesën më të madhe të kohës e kalojnë në rrjetet sociale ( $m=5,58$ ) ose rreth 3 orë, të ndjekura nga aktivitetet e lidhura me arsimin ( $m=4,95$ ) ose rreth 2 orë; leximi i gazetave online dhe platformave të informimit ( $m=3,2$ ) dhe kryerja e aktiviteteve që lidhen me punën me pagesë ( $m=3,17$ ) ose rreth 30 minuta.

**6.** Vlerësimi i përshtatjes së procesit arsimor me kërkesat e tregut të punës tregon se dy të tretat e të anketuarve (68,1 %) besojnë se kurikulat nuk janë të përshtatura për përgatitjen e të rinjve për punë, ndërsa vetëm 19,9 % besojnë se janë të përshtatura. Këto qëndrime mbeten të pandryshuara nga rezultatet e 2018/19.

**7.** Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve të punësuar (45 %) nuk punojnë në profesionin e tyre, duke treguar një mospërputhje midis sistemit arsimor dhe tregut të punës. Pothuajse gjysma (46 %) e tyre përballen me nënpunësim, pra punojnë në punë ku nuk arrijnë dot potencialin e tyre dhe ku aftësitë dhe kualifikimet e tyre janë të nënvlerësuara, gjegjësisht vendi i punës kërkon kualifikime më të ulëta.

**8.** Sa i përket sektorit të dëshiruar të punësimit, ka pasur një rritje të interesit për të punuar në sektorin privat dhe organizatat ndërkombëtare. Bazuar në vlerat mesatare, faktori «pagë» është më i rëndësishmi, ndërsa «puna me njerëzit» është më pak e rëndësishme në përzgjedhjen e punës.

**9.** Aktivitetet vullnetare janë në një nivel shumë të ulët dhe është e domosdoshme që të mobilizohen OJQ-të dhe institucionet qeveritare për të krijuar programe vullnetare.

## Rekomandime

**1.** Niveli i lartë i korrupsionit në arsim ka efekte negative në motivimin për të mësuar dhe punuar, besimin në institucione dhe emigrimin e talenteve të reja. Prandaj, lufta kundër korrupsionit në arsim duhet bërë prioritet. Kjo luftë nuk mund të bëhet e izoluar nga beteja e përgjithshme kundër korrupsionit në gjithë shoqërinë. Vetëm duke forcuar integritetin dhe transparencën në të gjitha nivelet e qeverisë dhe institucioneve mund të krijohen kushte për të trajtuar efektivisht korrupsionin në arsim dhe për të siguruar një ndjenjë ndershmërie dhe cilësie të arsimit.

**2.** Sa u përket lidhjeve midis arsimit dhe tregut të punës, bashkëpunimi midis institucioneve arsimore dhe industrisë duhet të forcohet për të siguruar që arsimit të jetë në përputhje me nevojat e tregut të punës. Nevojitet të bëhet përditësimi dhe azhurnimi i programeve mësimore për t'u siguruar që ato janë relevante dhe të përshtatura me tregun e punës. Kjo do t'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri dhe aftësi që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në punën e tyre të ardhme. Nevojitet të bëhet rishikim i programeve mësimore me qëllim që të përfshihen mësimet bashkëkohore dhe relevante që do të zhvillojnë mendimin kritik dhe zgjidhjen e problemeve. Programe që do të lejojnë më shumë trainim praktik dhe stazh praktik në bashkëpunim me sektorin privat dhe institucionet publike. Veçanërisht në zonat rurale, ekziston nevoja për të përmirësuar dhe modernizuar infrastrukturën arsimore (klasat moderne, laboratorët, mjediset e monitorimit, dixhitalizimi, tekstet shkollore). Trajnimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i stafit mësimor është një faktor shumë i rëndësishëm, jo vetëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, por edhe në luftën kundër korrupsionit në arsim.

**3.** Inkurajimi i prindërve dhe i komunitetit lokal për t'u përfshirë në këtë proces të «përmirësimit të cilësisë së arsimit dhe luftës kundër korrupsionit» do të jetë një vlerë e shtuar.

**4.** Përgatitja e të rinjve për tregun e punës dhe jetën në përgjithësi mund të arrihet edhe nëpërmjet programeve që inkurajojnë vullnetarizmin e të rinjve. Forcimi i vullnetarizmit të të rinjve duhet të jetë rezultat i një strategjie të përbashkët nga institucionet joqeveritare dhe shtetërore në drejtim të zhvillimit të programeve për aktivitete vullnetare midis të rinjve dhe vlerësimit të tyre për zhvillimin e mëtejshëm profesional.

# 5. Mobiliteti dhe migrimi

Mobiliteti mund të jetë për arsye arsimit ose pune, që do të thotë se një person banon përkohësisht jashtë vendit për një periudhë për arsye që lidhen me arsimin ose punën, ndërsa migrimi mund të jetë i brendshëm ose i jashtëm dhe përfshin largimin e përhershëm nga vendi i banimit, brenda ose jashtë vendit. Mobiliteti arsimor nxitet duke forcuar dhe përshtatur zonën evropiane të arsimin të lartë, si dhe nëpërmjet programeve evropiane të arsimin (p.sh. Erasmus dhe CEEPUS), ndërsa mobiliteti i punës është një domosdoshmëri në tregun global dhe konkurrues të punës, veçanërisht në aktivitetet dhe industrinë si TIK, industrinë krijuese, arsimin dhe shkenca, ndërtimtaria, shëndetësia/mjekësia, transporti, hotelieria dhe turizmi, prodhimtaria etj.

Hulumtimet zakonisht supozojnë se të rinjtë janë ose migrantë të varur të mbështetur nga prindërit e tyre, ose, ashtu si të rriturit, janë vetë migrantë ekonomikë (Tienda, Taylor, dhe Moghan, 2007). Ekzistojnë disa faktorë që e inkurajojnë rininë të migrojë, një prej të cilëve është motivimi i drejtpërdrejtë – dëshira për punësim dhe arsim, por edhe këto motive mund të jenë të rrënjësura në komponentë ideologjike, të tillë si faktorët kulturorë dhe psikosocialë (Massey et al., 1993).

Faktorët e emigrimit ndahen në faktorë «push» dhe «pull», një që e shtyn individin të largohet nga vendi i origjinës, dhe të tjerë që tërheqin individin në vendin – mëmë. Lee, 1966).


Pikërisht Studimet për të rinjtë të Fondacionit Friedrich Ebert (2013 dhe 2018/2019) ishin një mënyrë për t'i kushtuar vëmendje më serioze këtij fenomeni social në publikun e gjerë dhe ekspert, si dhe nga ana e institucioneve, mediave dhe organizatave të shoqërisë civile, në dhjetë vjetët e fundit. Shkalla e emigrimit nga vendet e Ballkanit Perëndimor është ndër më të lartat në Evropë (OECD, 2022). Rrjedhimisht, dëshira e të rinjve për të emigruar nga Republika e Maqedonisë së Veriut vijon në rritje (mbi 60%), gjë që konfirmohet nga studime të shumta (Topuzovska Llatkoviq et al., 2018/2019; Gjorjiovska & Galevski, 2021). Nga analiza e diferencave në regjistrimet e vitit 2001 dhe 2021, vihet re se gjithsej 18,2% e të rinjve që duhet të paraqiten në shifrat e regjistrimit të fundit, pra 77.274 të rinj, nuk janë më banorë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, edhe pse këtu kanë lindur dhe janë regjistruar si të lindur. (Maleski & Barllakovski, 2023).

I vetmi dokument strategjik në vend që i referohet procesit të «ikjes së trurit», edhe pse nuk u drejtohet drejtpërdrejt të rinjve, është Strategjia për rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe zvogëlimin e largimit të kuadrove me arsim të lartë dhe profesional 2013–2020, e cila nuk vazhdoi në periudhën e ardhme. Strategjia nacionale për rininë është duke u zhvilluar në vazhdimësi, në vitin 2018 filloi të zbatohet masa e Garancisë për të rinjtë dhe në vitin 2020 u miratua Ligji për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat rinore, përmes aktiviteteve dhe masave të të cilit, pritet të rritet cilësia dhe standardi i jetesës së të rinjve dhe si rezultat, t'i mbajë ata në shtet.



Fig. 11 Dëshira për emigrim mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)

*Sa e fortë është dëshira juaj për t'u shpërngulur në një shtet tjetër për më shumë se gjashtë muaj (emigrim)?*



## Qëndrimi jashtë shtetit

Shumica e të rinjve kanë qëndruar jashtë vendit për arsye arsimit apo trajnimit, gjegjësisht 92,6 % nuk kanë studiuar jashtë vendit (arsimi i lartë); 92,4 % nuk kanë kryer arsimin e mesëm jashtë vendit, 90,5 % nuk janë përfshirë në arsimin e mesëm profesional apo për formim jashtë vendit dhe një përqindje e lartë prej 39,4 % u përgjigjën se nuk kanë në plan të banojnë në të ardhmen për shkak të arsyeve që lidhen me arsimin dhe trajnimin (kjo përqindje është edhe më e lartë për grupmoshën më të re 14–18 vjeç me 47,3%). Vetëm 14,1 % e të rinjve kanë qëndruar jashtë vendit për më shumë se gjashtë muaj në mënyrë të vazhdueshme, dhe këta janë kryesisht të rinj të grupmoshës 19–24 vjeç (19,1%) dhe 25–29 (20,1%) për dallim nga mosha 14–18 vjeç. (1,7%).

## Dëshira për të migruar

Te të rinjtë mund të shihet një dëshirë e theksuar për migrim jashtë shtetit amë, me vlerë mesatare  $m=3,25$  në një shkallë prej 1 deri në 5.

Te të rinjtë mund të shihet një dëshirë e theksuar për migrim jashtë shtetit amë, me vlerë mesatare  $m=3,25$  në një shkallë prej 1 deri në 5. Gjithsej 39,2% kanë raportuar se kanë një dëshirë të fortë ose shumë të fortë për të migruar, 28,5% thanë se kanë një dëshirë të moderuar (gjithsej 67,7% kishin dëshirë të migronin, ose 73,4% pa përqindjen e atyre që nuk iu përgjigjën pyetjes), 12,2% kishin një dëshirë të dobët dhe 12,4% u përgjigjën se nuk kishin fare një qëllim/plan të tillë. 7,7% nuk u përgjigjën.

Nga nënmostra e të rinjve që kanë një dëshirë të moderuar, të fortë, ose shumë të fortë për të migruar ( $n=342$ ), gjithsej 58,2% mendojnë të largohen nga vendi në 5 vjetët e ardhme, dhe 15,9% të tjerë në 10 vjetët e ardhme, ndërsa 39,3% besojnë se do të qëndrojnë përgjithmonë në vendin – mëmë.

Për krahasim, në Studimin për të rinjtë 2018/2019 gjithsej 33% kishin një dëshirë të fortë ose shumë të fortë për të migruar dhe gjithsej 62% kishin njëfarë dëshirë për të migruar, rëndësia aritmetike ishte  $m=2,9$ , dhe përqindja e atyre që nuk kanë ndërmend të emigrojnë ishte 26%, duke treguar një trend në rritje të emigrimit tek të rinjtë gjatë pesë vjetëve të fundit.

Njohuri të tilla konfirmohen nga të dhënat e Entit shtetëror për statistikë, sipas të cilave ka edhe një trend në rritje të të rinjve që janë shpërngulur në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2022.

## 68 % e të rinjve kanë dëshirë të migrojnë jashtë

Popullsia e re në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka dëshirën më të lartë për të migruar, krahasuar me 11 (njëmbëdhjetë) vendet e tjera në të cilat është kryer anketa, dhe është e vetmja me notë mesatare mbi 3, apo në intervalin pozitiv të boshtit.

### Profili i të rinjve më të prirur për të emigruar

Analiza bivariante tregon se të rinjtë që kanë një dëshirë më të fortë për të migruar jashtë Maqedonisë së Veriut janë ata që:

- në një masë më të vogël, janë krenarë që janë shtetas të këtij vendi ( $r=-,180$ ,  $p<0,01$ )
- e imagjinojnë të ardhmen e shoqërisë maqedonase më keq se tani ( $r=-,263$ ,  $p<0,01$ )
- ndihen më shumë si qytetarë të Evropës ( $r=,147$ ,  $p<0,05$ )
- ndjejnë pakënaqësi të madhe me cilësinë e arsimit ( $r=-,174$ ,  $p<0,01$ )
- në masë të madhe konsiderojnë se ka korrupsion në arsim ( $r=,136$ ,  $p<0,01$ )
- ndjejnë një pakënaqësi të madhe me jetën në përgjithësi ( $r=-,188$ ,  $p<0,01$ )
- kanë pikëpamje më liberale mbi abortin ( $r=,111$ ,  $p<0,05$ ) dhe homoseksualitetin ( $r=,138$ ,  $p<0,01$ )
- konsiderojnë se interesat e të rinjve nuk janë të përfaqësuar mjaftueshëm në politikë ( $r=-,097$ ,  $p<0,05$ )
- pozicionohen në të majtë të boshtit të bindjeve politike/ideologjike ( $R=-,147$ ,  $p<0,05$ )

→ kanë ndjenja negative ndaj partive politike shqiptare: Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI) ( $r=-,153$ ,  $p<0,01$ ) dhe Aleanca për Shqiptarët ( $r=-,122$ ,  $p<0,05$ )

→ kanë besim më të ulët në Kuvend ( $r=-,231$ ,  $p<0,01$ ), Qeveri ( $r=-,177$ ,  $p<0,01$ ), partitë politike ( $r=-,233$ ,  $p<0,01$ ), pushtetin lokal ( $r=-,161$ ,  $p<0,01$ ), ushtri ( $r=-,175$ ,  $p<0,01$ ), drejtësi/gjyqësi ( $r=-,134$ ,  $p<0,01$ ), polici ( $r=-,206$ ,  $p<0,01$ ), institucionet fetare ku përkasin ( $r=-,142$ ,  $p<0,01$ ), media ( $r=-,235$ ,  $p<0,01$ ), Bashkimin Evropian ( $r=-,135$ ,  $p<0,01$ ), dhe NATO ( $r=-,192$ ,  $p<0,01$ ).

Të rinjtë që flasin gjuhën maqedonase kanë një dëshirë më të madhe për të migruar se rinia shqipfolëse ( $m=3,36$ , vs.  $m=2,87$ ,  $p<0,01$ ).

Nuk janë evidentuar dallime apo korrelacione të rëndësishme statistikore për sa i përket dëshirës për të migruar dhe grupmoshave apo statusit socio-ekonomik (niveli i arsimit, gjendja financiare në familje, vendi i banimit, statusi i punës), duke mos konfirmuar/përsëritur kështu tendencat nga Studimi për të rinjtë 2018/2019 dhe Studimi për të rinjtë të vitit 2013.

### Arsyet e migrimit

Pesë arsyet kryesore të migrimit mes të rinjve që kanë një dëshirë të moderuar, të fortë, ose shumë të fortë për të emigruar ( $n=342$ ) janë këto:


- përmirësimi i standardit të jetesës (30 %);
- paga më e lartë (14 %)
- korrupsioni dhe klientelizmi në atdheun tim (13 %);
- mundësi më të mira punësimi (10 %);
- stabilitet shoqëror dhe politik në vendin ku dua të shpërngulem (8 %).



Fig. 12 Dëshira për emigrim mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut, sipas vendit

*Sa e fortë është dëshira juaj për t'u shpërngulur në një shtet tjetër për më shumë se gjashtë muaj (emigrim)?*

Vlerat mesatare në një shkallë nga '1 – Nuk synoj të emigroj' deri në '5 – Shumë e fortë'



Tri nga pesë arsyet e mësipërme kanë të bëjnë me përmirësimin e gjendjes financiare dhe perspektivave të lidhura me punën, ndërsa dy arsyet e tjera i referohen disa fenomeneve shoqërore ose karakteristikave socio-politike të shoqërisë maqedonase, për të cilat të rinjtë besojnë se mungojnë ose se janë më pozitive në vendin e preferuar nikoqir. Kjo e bën të qartë se arsyet e migrimit në popullsinë e re janë një kombinim i faktorëve «push» dhe «pull». Të dhëna të tilla janë në përputhje me një raport të OECD (2022), sipas të cilit arsyet kryesore të migrimit të të rinjve nga Ballkani Perëndimor janë: nivelet e larta të papunësisë, pagat relativisht të ulëta, rezultatet e dobëta arsimore, siguria e ulët sociale, si dhe nivelet e larta të korrupsionit.

Në një përqindje më të vogël, shohim edhe arsye personale, si: të shpëtoj nga një situatë e pafavorshme (3%), të jem më afër njerëzve që dua (4,6%).

Testi Hi-katror dhe krostabulimi sipas grupmoshës së rritur nuk kanë regjistruar dallime të rëndësishme statistikore sa u përket arsyeve të migrimit.

Fig. 13 **Arsyet kryesore për emigrim mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)***Cila është arsyeja kryesore që ju shtyn të lëvizni në një shtet tjetër?*

30,5	Përmirësimi i standardit të jetesës
14,2	Pagat më të larta
12,9	Korrupsioni dhe klientelizmi në vendin tim të origjinës
9,9	Mundësitë më të mira të punësimit
7,7	Stabiliteti social dhe politik në vendin pritës
5,3	Arsimi më i mirë
4,6	Të qenit afër personave që dua
4,5	Mundësi më të mira për të nisur biznesin tim
4,0	Përjetimi i një kulture tjetër
3,0	Arratisja nga një situatë jo e favorshme
1,7	Diversiteti kulturor më i madh

## Aktivite të ndërmarra për mobilitet/migrim

Të rinjtë që kanë një dëshirë të moderuar, të fortë, ose shumë të fortë për t'u shpërngulur (n=342) kanë ndërmarrë veprimet e mëposhtme për të realizuar qëllimin e tyre:

- kontaktova ambasadën (7,1%)
- kontaktova punëdhënësit potencialë (17,6%)
- kontaktova universitetet/shkollat potenciale (10,9%)
- sigurova një bursë (3,6%)
- kontaktova me miqtë/të afërmit për të më ndihmuar që të shpërngulem jashtë vendit (29,3%)

Deri në 40% thanë se nuk kishin ndërmarrë asnjë veprim. Nuk mund të shfaqet përqindja e përgjithshme e të rinjve që kanë ndërmarrë ndonjë masë, sepse pyetja është formuluar me disa përgjigje të mundshme.

Rezultate të tilla tregojnë një proaktivitet të dobët të rinisë, pra pak veprim konkret të ndërmarrë në drejtim të shpërnguljes, gjë që vë në pikëpyetje vendosmërinë dhe planet për një hap të tillë. Mund të vihet re se të rinjtë mbështeten shumë te njerëzit e dashur për t'i ndihmuar të emigrojnë në një vend tjetër.

## Vëzhgime përmblylëse

- 1.** Shumica e të rinjve (mbi 90 %) nuk banojnë jashtë vendit për arsye që lidhen me arsimin dhe trajnimin e tyre dhe një përqindje e lartë prej 39,4 % u përgjigjën se nuk planifikojnë të banojnë as në të ardhmen për këto arsye.
- 2.** Te të rinjtë mund të vihet re një dëshirë e shtuar për migrim jashtë shtetit amë, me vlerë mesatare  $m=3,25$  në një shkallë prej 1 deri në 5. Shprehur si përqindje, gjithsej 67,7 % deklaruan se kishin njëfarë dëshirë për të migruar, ose 73,4 % pa ata që nuk iu përgjigjën pyetjes.
- 3.** Popullsia e re në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka tendencën më të madhe për migrim në rajon, krahasuar me 11 (njëmbëdhjetë) vendet e tjera në të cilat u krye sondazhi.
- 4.** Pesë arsyet kryesore për migrim midis të rinjve që kanë një dëshirë të moderuar, të fortë ose shumë të fortë për të emigruar janë si më poshtë: përmirësimi i standardeve të jetesës (30 %); paga më e lartë (14 %) korrupsioni dhe klientelizmi në vendin tim (13 %); mundësi më të mira punësimi (10 %); stabiliteti social dhe politik në vendin ku dua të shkoj (8 %).
- 5.** Deri në 40 % e të rinjve që kanë një dëshirë të moderuar, të fortë ose shumë të fortë për migrim, nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për të realizuar këtë qëllim.
- 6.** Profili i të rinjve që kanë tendencën më të madhe për të emigruar nuk përcaktohet nga karakteristikat e zakonshme demografike, si mosha dhe statusi socio-ekonomik, por më së shumti nga pakënaqësia dhe qëndrimi negativ ndaj fenomeneve të caktuara sociale në vend dhe mosbesimi i lartë në institucione.

## Rekomandime

- 1.** Përmirësimi i vazhdueshëm i standardeve të nxënësve dhe studentëve, si dhe investime në arsimin dhe infrastrukturën arsimore, që do të mundësojnë një arsimim cilësor dhe mbajtjen e rinisë në vendin amë.
- 2.** Krijimi i vendeve të punës për rininë dhe mbështetja e sipërmarrjes rinore.
- 3.** Rritja e vazhdueshme e pagave mesatare për përmirësimin e kushteve të punës, me qëllim që të zvogëlohet migrimi ekonomik.
- 4.** Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në institucione nëpërmjet masave kundër korrupsionit dhe kontroleve të rrepta.
- 5.** Krijimi i një mjedisi politik të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm nëpërmjet proceseve reformuese dhe pjesëmarrjes së të rinjve në politikë.
- 6.** Prezantimi i programeve të mobilitetit që do t'u mundësojë të rinjve të banojnë jashtë vendit me qëllimin për t'u arsimuar dhe trajnuar dhe pastaj të kthehen në vendin e tyre me njohuritë e fituara.
- 7.** Promovimi i shembujve të suksesshëm të të rinjve që kanë qëndruar dhe kanë arritur sukses në vendin e tyre.
- 8.** Vëzhgimi i vazhdueshëm i nevojave të rinisë dhe rregullimi i politikave në përputhje me to.

# 6 Familja dhe planet për të ardhmen

Deri më tani, gjetjet e hulumtimeve nga Studimi për të rinjtë (Topuzovska Llatkoviq etc., 2018/2019; Topuzovska Llatkoviq etc., 2013/2014) tregojnë se të rinjtë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në pjesën më të madhe (midis 70 % dhe 80 %) jetojnë në shtëpinë e familjes, me prindërit e tyre, kryesisht për arsye praktike dhe financiare, si dhe për shkak të disa normave socio-kulturore. Literatura shkencore konfirmon këtë shtyrje të pavarësisë së banimit të të rinjtë edhe në vende të tjera evropiane (Cordón, 1997; Sompolska-Rzechuła & Kurdyś-Kujawska, 2022). Sjellja e të rinjve kur largohen nga shtëpia e familjes është interesante për disa arsye: është një nga komponentët kryesorë, dhe shpesh një nga komponentët e parë, të kalimit në moshën madhore (Schizzerotto & Lucchini, 2004); dhe ka ndikim në fusha të rëndësishme politike, si kërkesa për banesë (Ermisch & Di Salvo, 1997) dhe rreziku i varfërisë së të rinjve (Aassve, Iacovou, Davia, & Mazzucco, 2007).

Të rinjtë që kanë të ardhura më të larta vetë, ose prindërit e të cilëve kanë të ardhura më të larta, kanë më shumë gjasa të largohen nga vendbanimi i familjes (për shkak se kanë mundësi të përballojnë kështu e qirasë ose huasë, faturat e shërbimeve publike dhe shpenzimet e tjera që lidhen me jetesën e pavarur).

Megjithatë, kjo realizohet vetëm nëse të rinjtë dhe/ose prindërit e tyre e vlerësojnë pavarësinë nga familja, aq sa të jenë të gatshëm të shpenzojnë para për të arritur këtë pavarësi. Pra, nëse një prej brezave ose të dy brezat e vlerësojnë më shumë bashkimin familjar se pavarësinë ndërmjet brezave, atëherë ata do t'i përqëndrojnë burimet e tyre në vazhdimin e jetesës së bashku (Iacovou, 2010).

## Me kë jetojnë të rinjtë dhe pse?

Shumica e të anketuarve jetojnë me prindërit e tyre (75,2 % me nënën dhe 65,8 % me babanë) dhe vëllezërit/motrat (49,2 %). Në disa familje jetojnë edhe gjyshi/gjyshja (13,4 %). Vetëm 15,4 % jetojnë me një partner/bashkëshort dhe 6,2 % me fëmijë të mitur. 6,1 % jetojnë vetëm dhe 2,8 % jetojnë me miqtë apo të afërm të tjerë. Nuk ka devijime të ndjeshme sa i përket nënmostrës së përbërë nga popullsia e të rinjve që kanë arritur maturinë (vetëm 8 % jetojnë vetëm, 69 % me prindërit, 20 % me një partner/bashkëshort, 8 % me fëmijë të mitur).

Më shumë se gjysma e nënmostrës së të rinjve të cilët kanë thënë se jetojnë me prindërit, janë përgjigjur që për ta kjo është zgjidhja më e thjeshtë dhe më e lehtë (54,5 %), ndërsa më shumë se një e treta (37,8 %) do të jetonin vetëm, por rrethanat financiare nuk e lejojnë këtë, 4,1 % kanë thënë se prindërit nuk i lejojnë të jetojnë ndaras dhe 1,4 % janë përgjigjur me «tjetër».

Një përqindje e lartë prej 45,6 % u përgjigjën se kanë raporte të shkëlqyeshme me prindërit, dhe 46,3 % se kanë raporte të mira, edhe pse ndonjëherë kanë mendime të ndryshme për çështje të caktuara. 5,5 % pajtohen dhe shpesh zihen dhe vetëm 1,5 % kanë marrëdhënie konfliktuozë me prindërit. Të dhënat e këtylla tregojnë se, për të rinjtë, dallimet mes brezave nuk përbëjnë një pengesë në zgjatjen e periudhës së bashkjetesës së tyre me prindërit, por gjithashtu konfirmojnë pamundësinë financiare të të rinjve për t'u bërë të pavarur përsa i përket banimit.



Fig. 14 Të rinjtë dhe (pavarësia) e banimit (in %)

Të rinjtë jetojnë me:		Arsyeja për të jetuar me prindërit:	
75,2	Nënë	54,5	Zgjidhja më e thjeshtë dhe më e përshtatshme
65,8	Babanë	37,8	Do të jetonin vetëm, por rrethanat financiare nuk i lejojnë
49,2	Vëllezër/motra	4,1	Prindërit nuk i lejojnë të jetojnë ndaras
13,4	Gjysh/Gjyshe	1,4	Tjetër
15,4	Partner/bashkëshort		
6,2	Fëmijë të mitur		
6,1	Vetëm		
2,8	Miq ose familjarë të tjerë		

Sipas gjetjeve, mund të shihet se vlera më e rëndësishme për të rinjtë është pavarësia, prandaj janë kryer teste joparametrike, të cilat vërtetojnë se nuk ka dallime të rëndësishme statistikore sipas grupmohave.

Konkretisht, për grupmohën më të re, kryesisht të mitur 14–18 vjeç, jetesa në bashkësinë familjare është zgjidhja më e thjeshtë dhe më komode (77,6 % përkundër 44,5 % për 19–24 dhe 50,5 % për 25–29 vjeç) dhe me përqindjen më të vogël problem për banimin ishin financat (16,4 % përkundër 51,6 % për 19–24 dhe 46,6 % për 25–29)

Mënyra e shpërndarjes së përgjigjeve nuk lejon teste plotësuese joparametrike për të analizuar dallimet dhe korrelacionet të rëndësishme statistikore sipas statusit socioekonomik të të anketuarve.

Ndaj pyetjes se si do ta përshkruanit gjendjen financiare të familjes, shumica e të rinjve (39,4 %) u përgjigjën se mund të blejnë disa gjëra më të shtrenjta, por jo aq të shtrenjta sa një makinë apo apartament, 28,7 % u përgjigjën se kanë para të mjaftueshme për ushqim, rroba dhe këpucë, por jo të mjaftueshme për gjëra më të shtrenjta (si frigorifer, televizor etj.), 10 % u përgjigjën se kanë para të mjaftueshme për faturat bazë dhe ushqim, por jo për rroba dhe këpucë, 9,3 % u përgjigjën se mund të blejnë gjithçka që u nevojitet për një standard të mirë jetese dhe 4,4 % u përgjigjën se nuk kanë para të mjaftueshme për faturat bazë (rrymë, ngrohje ...) dhe ushqim. 8,2 % nuk u përgjigjën.

## Statusi martesor dhe zgjedhja e partnerit

Sa i përket statusit martesor, 57 % janë beqarë, 20,9 % janë në një lidhje por nuk jetojnë së bashku, 12,9 % janë të martuar, 4,3 % jetojnë në bashkësi jashtëmartesore dhe më pak se 1 % janë të divorcuar ose të ve.

Tre faktorët më të rëndësishëm në zgjedhjen e një partner për të rinjtë janë si më poshtë:

- bindja fetare (m=3,74);
- prejardhja etnike (m=3,64);
- niveli i arsimit (m=3,54).

Në intervalin pozitiv të boshtit (në shkallë nga 1 deri në 5), si faktorë të rëndësishëm janë vlerësuar statusi ekonomik (m=3,41) dhe miratimi familjar (m=3,31). Vetëm virgjërisë si faktor në përzgjedhjen e bashkëshortit iu dha një vlerësim negativ (m=2,75).

Gjetjet lidhen me të dhënat e tjera të Studimit, të cilat tregojnë se në mesin e popullsisë së re në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka një ndarje të caktuar të qëndrimeve sipas identitetit fetar dhe etnik.

Janë vënë re dallime statistikisht të rëndësishme sipas gjinisë, ku doli se për të anketuarit të gjinisë femërore janë më të rëndësishme bindjet fetare të partnerit (f. 3,89; m. 3,55), prejardhja etnike (f. 3,85; m. 3,34), niveli i arsimit (f. 3,69; m. 3,35), dhe statusi ekonomik (f. 3,74; m. 2,9).

Virgjëria si virtyt është karakteristikë më e rëndësishme për të anketuarit të gjinisë mashkullore (m. 2,98; f. 2,56), si dhe për anëtarët e grupmoshës më të re (14–18 vjeç m=3,31; 19–24 vjeç m=2,75; 25–29 vjeç m=2,39), me dallime të rëndësishme statistikore.

## Planet për t'u bërë prind

Kur u pyetën se sa fëmijë do të donin të kishin gjatë jetës së tyre, përgjigjet e marra varionin nga 1 deri në 7, me një vlerë mesatare prej m=2,48, që do të thotë se të rinjtë mesatarisht planifikojnë të kenë dy (deri në tre) fëmijë. Mosha në të cilën ata do të donin të kishin fëmijën e tyre të parë është nga 19 deri në 36 vjeç (me moshë mesatare m=27,86). Natyrisht, ka dallime të rëndësishme statistikore sipas gjinisë, me pak dallim midis moshës së preferuar të atësisë për meshkujt (m=28,62) dhe amësisë për femrat (m=27,23). Më pak se 1% u përgjigjën se nuk kanë në plan të kenë fëmijë dhe gjithsej 27% nuk dinë ose nuk kanë një përgjigje për këtë pyetje.

Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2021, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, një familje me fëmijë nën moshën 25 vjeç ka mesatarisht katër anëtarë (nënë, baba dhe dy fëmijë), dhe mosha mesatare e femrës që bëhet nënë është 28,1 vjeç (Enti shtetëror për statistikë, 2024). Trendet e këtilla konfirmohen edhe me rezultatet hulumtuese të Studimit.

## Vëzhgime përmbyllëse

1. Shumica e të anketuarve jetojnë me prindërit e tyre (75,2%).
2. Më shumë se gjysma e të rinjve që u përgjigjën se jetojnë me prindërit e tyre, u shprehën se kjo është zgjidhja më e thjeshtë dhe më e rehatshme për ta (54,5%), ndërsa më shumë se një e treta (37,8%) thanë do të donin të jetonin vetëm, por rrethanat financiare nuk e lejojnë këtë gjë.

**3.** Një përqindje e lartë prej 45,6% u përgjigjën se ia kalojnë shumë mirë me prindërit, ndërsa 46,3% thanë se pajtohen, edhe pse ndonjëherë mendimet e tyre janë të ndryshme. Këto të dhëna konfirmojnë se për të rinjtë që jetojnë bashkë me prindërit, dallimet midis brezave nuk përbëjnë pengesë.

**4.** Tre faktorët më të rëndësishëm për të rinjtë në zgjedhjen e një partneri janë bindja fetare (m= 3,74); prejardhja etnike (m=3,64) dhe niveli i arsimit (m=3,54).

**5.** Të rinjtë mesatarisht planifikojnë të kenë dy (deri në tre) fëmijë. Periudha e moshës në të cilën ata do të dëshironin të kishin fëmijën e tyre të parë është 19 deri në 36 vjeç (me një moshë mesatare m= 27,86), me pak dallim midis moshës së preferuar për atësi për meshkujt (m= 28,62) dhe amësi për femrat (m= 27,23).

## Rekomandime

**1.** Mbështetje për një jetesë të pavarur për të rinjtë përmes subvencioneve dhe kredive të favorshme për ata që duan të fillojnë një jetë të pavarur, duke përfshirë strehimin social dhe mbështetjen financiare për blerjen e parë të banesës.

**2.** Prezantimi i programeve arsimore për edukim financiar për të ndihmuar të rinjtë në menaxhimin e duhur të financave të tyre dhe në planifikimin e të ardhmes.

**3.** Ofrimi i shërbimeve të aksesueshme dhe cilësore të kujdesit për fëmijët.

**4.** Orare fleksibile të punës dhe leje prindërore që do t'i lejojnë të rinjtë të kujdesen për fëmijët e tyre të mitur pa rrezikuar zhvillimin e tyre në karrierë.

# 7 Vlera, qëndrime dhe perceptime të përgjithshme

Vlerat, sipas Rokeach (1973), përkufizohen si besime të qëndrueshme dhe mënyra specifike të sjelljes së dëshiruar. Vlerat kanë një ndikim të konsiderueshëm mbi veprimet dhe vendimet e një individi në të ardhmen; ato përcaktojnë besimin e njerëzve në raport me atë që është thelbësisht e drejtë apo e gabuar. Vlerat përmbajnë attribute cilësore dhe sasiore. Atributi cilësor apo përmbajtësor tregon se një mënyrë e caktuar e sjelljes ose vetë gjendja e ekzistencës janë të rëndësishme. Atributi sasior ose i intenzitetit precizon se sa e rëndësishme është ajo. Nëse rendisim vlerat e një individi sipas intensitetit të tyre, mund të kuptojmë sistemin ose hierarkinë e vlerave të tij. Vlerat janë themelet që bëjnë të mundur të kuptojmë qëndrimet dhe motivet e njerëzve dhe ndikojnë mbi perceptimet.

Perceptimi është procesi me të cilin individët organizojnë dhe interpretojnë përshtypjet e tyre shqisore për t'u dhënë kuptim rrethanave të tyre (Robbins, 2013). Megjithatë, ajo që ne perceptojmë mund të ndryshojë ndjeshëm nga realiteti objektiv. Kur gjykojmë dikë bazuar në perceptimin tonë për grupin të cilit ai i përket, shpesh shkojmë nga rruga më e shkurtër dhe përdorim paragjykitime dhe stereotipe.

Diskriminimi dhe intoleranca shpeshherë, me vetëdije ose pa vetëdije, bazohen ose arsyetohen me anë të paragjykimeve dhe stereotipeve për njerëz dhe grupe shoqërore të caktuara. Diskriminim do të thotë dallim, përjashtim, kufizim dhe çdo lloj forme e vendosjes në një situatë të padëshiruar mbi çfarëdo baze të një personi ose grupi personash.

Qëndrimet, nga ana tjetër, janë një grup emocionesh, besimesh dhe sjelljesh ndaj një objekti, personi ose ngjarjeje të veçantë. Kjo është arsyeja pse ne themi se ato përmbajnë tre komponentë (afektiv, njohës dhe të sjelljes) (Ostrom, 1969). Qëndrimi mund të përshkruhet, gjithashtu, si mënyra se si vlerësojmë diçka ose dikë, me ç'rast priremi të reagojmë pozitivisht ose negativisht. Qëndrimet formohen si rezultat i përvojave të jetës, edukimit, arsimimit dhe ndikimeve shoqërore.

## Vlerat më të rëndësishme

Për të rinjtë më e rëndësishme në radhë të parë është që të jenë të pavarur (m=4,45), në radhë të dytë të hanë shëndetshëm (m=4,22), në radhë të tretë të kenë një karrierë të suksesshme (m=4,21), në radhë të katërt të kenë fëmijë (m=4,16), në radhë të pestë të marrin përgjegjësi (m=4,13), në radhë të gjashtë të luajnë sporte (m=4,11), në radhë të shtatë të martohen (m=4,03), në radhë të tetë të duken mirë (m=4,02), në radhë të nëntë të diplomohen (m=4), në radhë të dhjetë të jenë të pasur (m=3,6).

Për ta është më pak e rëndësishme të jenë politikisht aktivë (m=2,19), të veshin garderobë të markave (m=2,5) dhe të marrin pjesë në aktivitetet/iniciativa qytetare (m=3,02).


Analiza plotësuese tregon se ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në vlerë sipas gjinisë. Gjegjesisht, për vajzat e reja është më e rëndësishme që të hanë shëndetshëm (m=4,36 përkundër m=4,04), të jenë të pavarura (m=4,52 përkundër m=4,36) dhe të përfundojnë arsimin universitar/diplomohen (m=4,19 përkundër m=3,75) krahasuar me djemtë e rinj. Nga ana tjetër, të qenët politikisht aktiv është më e rëndësishme për djemtë sesa për vajzat (m=2,38 përkundër m=2,05).



Fig. 15 Vlerat më të rëndësishme për të rinjtë në Maqedoninë e Veriut

Sa të rëndësishme janë për ju gjërat e mëposhtme?

Vlerat mesatare në një shkallë nga '1 – Aspak të rëndësishme' deri në '5 – Shumë të rëndësishme'



## Përmbushja nga jeta dhe planet për të ardhmen

Të rinjtë, në përgjithësi, janë të kënaqur me jetën e tyre, me një mesatare prej  $m=7,11$  (në një shkallë nga 1 – shumë i/e pakënaqur deri në 10 – shumë i/e kënaqur). Përmbushja më e madhe vihet re në grupmoshën 14–18 vjeç, për të cilën janë regjistruar dallime të rëndësishme statistikore. Të rinjtë janë optimistë kur bëhet fjalë për të ardhmen e tyre personale në 10 vitet e ardhshme, ndërkohë që janë pesimistë për të ardhmen e shoqërisë maqedonase. Më konkretisht, 70% e imagjinojnë të ardhmen e tyre më mirë se tani (5,7% e imagjinojnë atë më keq, 11,7% njësoj si tani), dhe vetëm 28,6% e imagjinojnë të ardhmen e shoqërisë maqedonase më mirë se tani (34,9% e imagjinojnë atë më keq se tani, 23% njësoj si tani).

Të rinjtë veçojnë gjashtë nga dymbëdhjetë përgjigjet e mundshme në vijim, si problemet më të mëdha potenciale për shtetin në dekadën e ardhme:

- korrupsioni (63,2%)
- largimi nga vendi i fuqisë së kualifikuar punëtore (55,3%)
- cilësia e shërbimeve publike (shëndetësi, arsim) (51,4%)
- papunësia (51,2%)
- emigracioni (40,3%)
- pabarazia (40,3%).

Gjatë gjithë Studimit, qëndrimi negativ i të rinjve ndaj korrupsionit përsëritet dhe konfirmohet si një problem kyç, që është i pranishëm në të gjitha sferat shoqërore.



Migrimi shihet gjithashtu si një kërcënim real që dobëson ekonominë dhe tregun e punës, veçanërisht duke marrë parasysh aspiratat e të rinjve për t'u larguar nga vendi i tyre. Problemi tjetër i parashikuar është sigurisht një produkt i të lartpërmendurave, pasi korrupsioni dhe mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar pritet të kenë një ndikim negativ në cilësinë e shërbimeve publike, veçanërisht në arsim dhe shëndetësi, si aktivitete që kërkojnë nivele të larta të kompetencës dhe njohurive, dhe përfaqësojnë të drejtat themelore sociale. Edhe pse aktualisht papunësia (te popullata e re dhe në përgjithësi) është në një nivel më të ulët, të rinjtë ende parashikojnë se në të ardhmen do të jetë një problem social. Siç tregojnë dhe rezultatet e tjera hulumtuese, të rinjtë kanë frikë nga fluksi i emigrantëve në vend, pas kësaj edhe nga pabarazia.

## Frikëra dhe shqetësime

Kushtet dhe fenomenet që shkaktojnë frikërat dhe shqetësimet më të mëdha personale tek të rinjtë janë sistemi i dobët shëndetësor (m=2,63); ndotja dhe ndryshimet klimatike (m=2,43); mungesa e punës (m=2,39); mungesa e një pensioni të mirëfilltë (m=2,37); sëmundja e rëndë (m=2,36).

**70%**

e imagjinojnë të ardhmen e tyre si më të mirë se tani, por vetëm 29% e imagjinojnë të ardhmen e shoqërisë së tyre si më të mirë se tani

Rritja e frikës për shëndetin e tyre (dhe të të tjerëve) mund të jetë gjithashtu për shkak të përbërjes së të rinjve me gjendjen e krizës globale të shëndetit, të shkaktuar nga pandemia Covid-19.

Për pothuajse të gjitha modalitetet e ofruara, vlerat mesatare janë mbi 2 (në shkallë me tre nivele, 1 – aspak, 2 – deri diku, 3 – shumë), gjegjësisht në intervalin pozitiv të boshtit. Në mesin e të rinjve, gjithashtu, (si rrjedhojë) janë të pranishme edhe frika nga lufta (m=2,29); pandemia globale (m=2,24); numri i tepërt i emigrantëve dhe refugjatëve (m=2,23); grabitja (m=2,22); sulmi terrorist (m=2,19), problemet lidhur me banimin (m=2,19), efektet negative të inteligjencës artificiale (m=2,17); dhuna fizike (m=2,15) dhe dhuna seksuale (m=2,1).

Me vlerë më të ulët renditen frika apo shqetësimi nga të qenët viktimë e dhunës në familje (m=1,98), e cila ndoshta është edhe për shkak të moshës specifike biologjike, gjegjësisht për shkak të përqindjes së vogël të subjekteve që aktualisht jetojnë në një bashkësi martesore ose jashtëmartesore.

## Shëndeti mendor

Të rinjtë japin vlerësime të larta pozitive (në një shkallë nga 1 deri në 5) për shëndetin e tyre mendor (m=3,9) dhe qëndrimin ndaj jetës (m=3,77) dhe tregojnë një nivel të mirë të informimit për mundësitë që janë në dispozicion kur kanë nevojë për mbështetje (m=3,52), si dhe janë të hapur për të diskutuar mbi temën (m=3,73). Të dhënat e këtylla, si dhe përqindja e ulët e të anketuarve që nuk u përgjigjën, na bëjnë të kuptojmë që ekziston një nivel i zhvilluar ndërgjegjësimi dhe se shëndeti mendor nuk është një temë tabu në mesin e të rinjve. Megjithatë, duhet patur parasysh se të gjitha vlerat mesatare variojnë midis 3,5 dhe 3,9, dhe nuk është regjistruar asnjë vlerë e lartë midis 4 dhe 5.

Korrelacioni bivariant tregon se subjektet me gjendje më të mirë financiare në familje kanë rezultate më të larta për të gjitha deklaratat e lidhura me shëndetin mendor.

Testet joparametrike nuk kanë evidentuar dallime të rëndësishme statistikore në bazë të grupmoshës dhe gjinisë.


## Sjellje e (pa)pranueshme

Për të rinjtë, llojet e mëposhtme të sjelljes janë të papranueshme: pranimi/dhënia e ryshfetit (m=2,56), evazoni fiskal (m=2,70), homoseksualiteti (m=2,79), aborti (m=4,15), shfrytëzimi i lidhjeve për të kryer një punë (m=4,25). Të gjitha përgjigjet ndodhen në pjesën negative të boshtit, duke marrë parasysh se është një shkallë me dhjetë nivele (1 – asnjëherë, 10 – gjithmonë). Nga rezultatet mund të arrihet në përfundimin se midis të rinjve ekziston një lloj konservatorizmi në lidhje me abortin dhe homoseksualitetin, si të drejta të njeriut. Diçka pozitive është që të rinjtë janë kundër formave të sjelljes korruptive, gjë që konfirmohet nga gjetjet e tjera hulumtuese të Studimit.

Fig. 16 **Frikat dhe shqetësimet mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut**

*Sa të frikësuar dhe të shqetësuar jeni në lidhje me gjërat e mëposhtme?*

Vlerat mesatare në një shkallë nga '1 – aspak' deri në '3 – shumë'



Megenëse devijimi standard është rreth 3, janë bërë analiza statistikore plotësuese dhe janë evidentuar dallime të rëndësishme statistikore në raport me grupmoshat.

Të rinjtë nga grupmosha e mesme 19–24 kryesisht e arsyetojnë abortin (m=4,88 përkundër m=3,27 për 14–18 dhe m=3,96 për 25–29), homoseksualitetin (m=3,28, përkundër m=2,22 për 14–18 dhe m=2,65 për 25–29), evazionin fiskal (m=3,11, përkundër m=2,34 për 14–18 dhe m=2,55 për 25–29), ryshfetin (m=2,95, përkundër m=2,20 për 14–18 dhe m=2,49 për 25–29), shfrytëzimin e lidhjeve (m=4,83, përkundër m=3,79 për 14–18 dhe m=3,92 për 25–29).

Siç mund të vihet re, të rinjtë nga grupmosha 14–18 vjeç i pranojnë më së paku këto lloj sjelljesh. Nuk janë identifikuar dallime të rëndësishme statistikore sipas gjinisë.

Në vitin 2019/2020, me iniciativën e disa shoqatave të shoqërisë civile në vend, si dhe në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare (si UNESCO, UNDP, OBSH, UNFPA – Fondi i OKB mbi Popullsinë), Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit zhvilluan një projekt-kurrikulë për përfshirjen e edukimit gjithëpërfshirës seksual (EGJS) në shkolla dhe u hartua një Manual fillestar për mësime të përbashkëta për zbatimin e kësaj kurrikule për periudhën e moshës 12–14 vjeç.

Modeli i edukimit gjithëpërfshirës seksual ishte në përputhje me rekomandimet e fundit të UNESCO-s (UNESCO 2018) dhe përfshinte shtatë pjesë përmbajtësore, që u propozuan të mësohen në sistemin arsimor, të përshtatura për moshën dhe nevojat e fëmijëve: (1) Gjinia, (2) Lidhjet dhe marrëdhëniet, (3) Trupi dhe qëndrimi ndaj trupit (4) Shëndeti seksual dhe riprodhues, (5) Seksualiteti, (6) Dhuna dhe (7) Aspektet qytetare. Iniciativa u tërhoq për shkak të rezistencës së fortë nga grupe të caktuara në shoqëri, të cilët shprehën shqetësim për përmbajtjen dhe qasjen e arsimit, si dhe për shkak të kuptimit dhe mbështetjes së pamjaftueshme nga publiku i gjerë dhe nga institucionet.

## Religjioni

Shumica e të anketuarve i përkasin komunitetit fetar ortodoks (54,7%), dhe më pas komunitetit fetar mysliman (23,4%). Një në dhjetë të rinj nuk identifikohet me asnjë komunitet fetar. 8,6% nuk u përgjigjën dhe 2,7% u përgjigjën me «tjetër».

**72%** besojnë se njerëzit e varfër kanë të drejtat më të pakta, të ndjekur nga të rinjtë vetë (52%)

Sa i përket nivelit të praktikimit të fesë, një e treta e të anketuarve (33,4%) që i përket një prej komuniteteve fetare, përveç në dasma dhe funerale, u përgjigjën se marrin pjesë në rite fetare vetëm në ditë të shenjta të veçanta; 4,3% e bëjnë këtë më shpesh se një herë në javë, 7,1% një herë në javë, 13,6% një herë në muaj, 11,6% një herë në vit, 8,9% më rrallë se një herë në vit dhe 11,9% pothuajse kurrë.

## Distanca sociale

Të rinjtë tregojnë distancë sociale ndaj personave ose familjeve me orientime të ndryshme seksuale dhe grupeve të tjera shoqërore. Ndaj pyetjes «si do të ndiheshit nëse një nga familjet ose personat e mëposhtëm shpërngulet në lagjen tuaj?», u fituan vlera mesatare mbi 3 (në një shkallë nga 1 deri në 5), që tregojnë një qëndrim pozitiv: të krishterë (m=4,12) dhe myslimanë (m=3,45). Qëndrim neutral (m=3) ekziston ndaj grupeve: romë dhe hebrenj, dhe një qëndrim negativ ndaj: anëtarëve të komunitetit LGBT (m=2,31) dhe të varurve nga droga (m=1,71).

Nuk janë evidentuar dallime të rëndësishme statistikore sipas grupmoshës dhe pozicionimit ideologjik.

## Diskriminimi


Kur u pyetën nëse ishin ndjerë ndonjëherë të diskriminuar për arsye të ndryshme, në përgjithësi të rinjtë u përgjigjën negativisht. Gjegjësisht, të gjitha vlerat mesatare janë më të ulëta se 2 (në një shkallë me tre nivele), dhe ndodhen në intervalin negativ të boshtit:

- Në bazë të gjinisë suaj (mashkull/femër/tjetër) (m=1,35);
- Në bazë të prejardhjes ekonomike (i varfër/i pasur) (m=1,51);
- Në bazë të besimit fetar (m=1,42);
- Në bazë të prejardhjes etnike (m=1,44);
- Në bazë të bindjeve politike (m=1,43);
- Në bazë të orientimit seksual (m=1,19);
- Në bazë të gjuhës që flisni (m=1,48).

Shkalla ka një nivel të lartë besueshmërie dhe konsistence të brendshme ( $\alpha=,810$ ). Prandaj, është e rëndësishme të theksohet se të rinjtë që kanë përjetuar nivele më të larta të diskriminimit përballen njëkohësisht me lloje të shumta dhe të ndryshme të diskriminimit.

Fig. 17 Qëndrimet ndaj të drejtave të pakicave mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)

Tregoni nëse sipas mendimit tuaj, grupet e mëposhtme kanë të drejta të mjaftueshme, nuk kanë të drejta të mjaftueshme ose kanë më shumë të drejta seç duhet në vendin tuaj?



Për shembull, të rinjtë që ndjehen të diskriminuar për shkak të orientimit të tyre seksual, në një masë më të madhe ndjejnë gjithashtu diskriminim në bazë të gjinisë ( $r = ,507$ ,  $p < 0,01$ ), prejardhjes ekonomike ( $r = ,305$ ,  $p < 0,01$ ), besimeve fetare ( $r = ,465$ ,  $p < 0,01$ ), prejardhjes etnike ( $r = ,413$ ,  $p < 0,01$ ), besimeve politike ( $r = ,450$ ,  $p < 0,01$ ), dhe gjuhës që ata flasin ( $r = ,373$ ,  $p < 0,01$ ).

Diskriminimi i shumëfishtë në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, që lidhet me përkatësinë etnike, është vënë re edhe nga organizatat e shoqërisë civile në vend (Stojanovski, 2016; Mihajilov, 2020).

## Të drejtat e grupeve

Në vijim janë paraqitur qëndrimet dhe perceptimet e të anketuarve ndaj të drejtave të grupeve të caktuara në shoqëri. Të rinjtë besojnë se të varfërit kanë më pak të drejta nga të gjithë (71,5%), e pas tyre vetë të rinjtë (51,7%). Shumica e përgjigjeve tregojnë se gratë (48,9%) dhe pakicat etnike (31,3%) kanë mjaftueshëm të drejta. Për anëtarët e komunitetit LGBT+, mbizotëron përgjigja se ata kanë tepër të drejta (27,5%).


Një fakt interesant është se të rinjtë e perceptojnë veten si grupi i dytë i marginalizuar ose grup të cilit i shkelen të drejtat. Gjithashtu, është mirë të theksohet se në Studim, të rinjtë renditën të drejtat e njeriut në vend të parë në listën e vlerave më të rëndësishme.<sup>3</sup> Kjo vetëdije e zhvilluar mund të jetë për shkak të aktiviteteve të organizatave të shoqërisë civile për promovimin e të drejtave dhe lirive të të rinjve dhe mekanizmave për praktikimin e tyre në jetën e përditshme.

## Qëndrimet shoqërore dhe nacionaliste

Sipas gjetjeve të hulumtimit, të rinjtë tregojnë dhe posedojnë proteksionizëm/qëndrim kulturor për të mbrojtur identitetin kulturor nga përzierja me kulturat e tjera, tolerancë të ulët për personat me orientim tjetër seksual ose përkatësi tjetër etnike.

Fig. 18 Mendimet shoqërore mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut

Vlerat mesatare në një shkallë nga '1 – aspak dakord' deri në '4 – Jam dakord'



Për secilën nga deklaratat për të matur qëndrimet shoqërore, të anketuarit u përgjigjën përmes një shkalle të pajtimit nga 1 deri në 4 (ku mesatarja është 2,5), dhe rezultatet treguan se:

- Të rinjtë kanë qëndrime negative ndaj deklaratave se çiftet e seksit të njëjtë duhet të kenë të drejtën të martohen ( $m=1,98$ ) dhe çiftet e seksit të njëjtë janë prindër po aq të mirë sa çdo çift tjetër ( $m=1,96$ );
- Të rinjtë kanë një qëndrim negativ ndaj deklaratës se emigrantët pasurojnë kulturën tonë ( $m=2,05$ ), dhe një qëndrim të fortë pozitiv se ne duhet ta mbrojmë kulturën tonë nga ndikimi i kulturave të tjera ( $m=3,28$ );
- Të rinjtë kanë qëndrim negativ me tendencë drejt neutralitetit se ekziston një hierarki natyrore midis «njerëzve të zinj dhe të bardhë» ( $m=2,37$ ) dhe se hebrenjtë kanë tepër ndikim në vendin tonë ( $m=2,29$ );
- Të rinjtë nuk pajtohen se burrat janë udhëheqës më të mirë politikë se gratë ( $m=2,36$ ) dhe se kur ka shumë pak vende pune, burrat duhet të kenë më shumë të drejtë pune se gratë ( $m=2,05$ ).

Testet joparametrike nuk kanë regjistruar dallime të rëndësishme statistikore sipas grupmohës. Megjithatë, ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore sipas gjinisë. Gratë e anketuara kryesisht nuk pajtohen me deklaratën se burrat janë udhëheqës më të mirë politikë se gratë ( $m=2,09$  përkundër  $m=2,72$ ) dhe se kur ka shumë pak vende pune, burrat duhet të kenë më shumë të drejtë pune se gratë ( $m=1,88$  përkundër  $m=2,28$ ), dhe në një masë më të madhe pajtohen se çiftet e seksit të njëjtë duhet të kenë të drejtën për t'u martuar ( $m=2,07$  përkundër  $m=1,86$ ) dhe çiftet e seksit të njëjtë janë prindër po aq të mirë sa çdo çift tjetër ( $m=2,08$  përkundër  $m=1,80$ ).

Mund të arrihet në përfundim se anëtarët e popullsisë së re femërore, në një masë më të madhe besojnë në barazinë gjinore në sferën e punës dhe politikës, dhe se ato kanë një ndjeshmëri më të madhe ndaj temave që mbulojnë të drejtat e njeriut, për dallim nga anëtarët e popullsisë së re mashkullore.

Më tej, të rinjve iu parashtruan dhe pyetje të tjera (në një shkallë nga 1 deri në 5) për të matur qëndrimet nacionaliste, me ç'rast të anketuarit me vlera mesatare mbi 3 u përgjigjën se janë krenarë që janë qytetarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut (m=3,31) dhe se jo-maqedonasit që jetojnë në Maqedoninë e Veriut duhet të pranojnë zakonet dhe vlerat e maqedonasve (m=3,50). Ndërkaq, me vlera mesatare nën 3, të rinjtë shprehën mospajtim me qëndrimet se do të ishte më mirë nëse vetëm maqedonasit do të jetonin në Maqedoninë e Veriut (m=2,87) dhe se vendi duhet të pranojë/mirëpresë më shumë emigrantë (m=1,92).

Testet joparametrike tregojnë se të anketuarit nga grupmosha më e re 14–18 vjeç janë kryesisht janë krenarë që janë shtetas maqedonas. Ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore të përgjigjet sipas përkatësisë fetare të të anketuarve në raport me pothuajse të gjitha deklaratat, gjë e cila pritet, pasi shoqëria maqedonase është multikulturore, ndërkohë që pyetjet lidhen me identitetin kombëtar maqedonas.

## Mjedisi jetësor

Të rinjtë në përgjithësi tregojnë një eko-ndërgjegjësim mesatarisht të zhvilluar dhe një qëndrim pozitiv për çështjet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, kështu që me një vlerë mesatare prej m=3,13 (në një shkallë prej 1 deri në 5) ata u përgjigjën se shteti duhet të kufizojë konsumin, nëse kjo është një mënyrë për ta mbrojtur mjedisin (për shembull, duhet të ndalohet përdorimi i makinave të vjetra që ndotin mjedisin), megjithëse ekziston dallim në mendime. Përkatësisht, gjithsej 41,1% u përgjigjën se janë dakord ose se janë shumë dakord, 31,7% thanë se nuk janë as dakord as jodakord dhe 27,2% thanë se nuk janë dakord ose se nuk janë aspak dakord.

## Vëzhgime përmblyëse

**1.** Për të rinjtë është më e rëndësishme në 1. radhë të parë të jenë të pavarur (m=4,45), në radhë të dytë të ushqehen shëndetshëm (m=4,22), në radhë të tretë të kenë një karrierë të suksesshme (m=4,21), në radhë të katërt të kenë fëmijë (m=4,16), në radhë të pestë të marrin përgjegjësi (m=4,13). Më pak e rëndësishme për ta është të jenë politikisht aktivë (m=2,19), të veshin garderobë të markave (m=2,5) dhe të marrin pjesë në aktivitete/iniciativa qytetare (m=3,02).

**2.** Të rinjtë janë përgjithësisht të kënaqur me jetën e tyre, me një mesatare prej m=7,11 (në një shkallë nga 1 – shumë të pakënaqur deri në 10 – shumë të kënaqur).

**3.** Të rinjtë janë optimistë kur bëhet fjalë për të ardhmen e tyre personale, në 10 vjetët e ardhshme, ndërkohë që janë pesimistë për të ardhmen e shoqërisë maqedonase. Gjegjësisht, 70% e imagjinojnë të ardhmen e tyre më mirë se tani dhe vetëm 28,6% e imagjinojnë të ardhmen e shoqërisë maqedonase më mirë se tani.

**4.** Të rinjtë evidentojnë të mëposhtmet si problemet më të mëdha potenciale për vendin në dekadën e ardhme: korrupsionin (63,2%), largimin e fuqisë së kualifikuar punëtore nga vendi (55,3%), cilësinë e shërbimeve publike (shëndetësi, arsim), (51,4%), papunësinë (51,2%), emigracionin dhe pabarazinë (me një përqindje identike prej 40,3%).

**5.** Kushtet dhe fenomenet që më së shumti shkaktojnë frikë dhe shqetësim personal tek të rinjtë janë sistemi i dobët shëndetësor (m=2,63); ndotja dhe ndryshimet klimatike (m=2,43); mungesa e punës (m=2,39); mungesa e një pensioni të mirëfilltë (m=2,37); sëmundja e rëndë (m=2,36).

**6.** Të rinjtë kanë një perceptim pozitiv lidhur me shëndetin e tyre mendor (m=3,9 në një shkallë nga 1 deri në 5);

**7.** Mund të vihet re një lloj konservatorizmi midis të rinjve në raport me abortin dhe homoseksualitetin.

**8.** Të rinjtë mbajnë distancë sociale ndaj personave ose familjeve me përkatësi të ndryshme fetare, orientim seksual dhe grupeve të tjera shoqërore

**9.** Në përgjithësi, të rinjtë nuk kanë shprehur ndjesi diskriminimi. Megjithatë, analizat plotësuese tregojnë se të rinjtë me orientim tjetër seksual përballen me diskriminim të shumëfishtë.

**10.** Të rinjtë janë kundër formave të sjelljes korruptive.

**11.** Të anketuarit konsiderojnë se të varfërit kanë më pak të drejta (71,5%), dhe pas tyre të rinjtë (51,7%). Mbizotëron mendimi se gratë (48,9%) dhe pakicat etnike (31,3%) kanë mjaftueshëm të drejta. Për anëtarët e komunitetit LGBT+, mbizotëron mendimi se ata kanë tepër të drejta (27,5%).

**12.** Të rinjtë në përgjithësi posedojnë pro-teksionizëm/qëndrim kulturor për të mbrojtur identitetin kulturor nga përzierja me kultura të tjera, tolerancë të ulët për njerëzit me orientim tjetër seksual dhe përkatësi tjetër etnike. Nuk mund të përgjithësohet nëse bëhet fjalë për ksenofobi për shkak të dëshirës së shprehur për të emigruar.

**13.** Të rinjtë tregojnë eko-ndërgjegjësim pjesërisht të zhvilluar dhe qëndrim pozitiv për çështjet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

## Rekomandime

**1.** Qendra karriere dhe programe mentori-mi për të ndihmuar të rinjtë që të ndërtojnë një karrierë të suksesshme, si dhe krijimi i platformave për të lidhur të rinjtë me punëdhënësit dhe mentorët e mundshëm.

**2.** Mbështetje për programe trajnimi mbi të drejtat e njeriut dhe tolerancën, përfshirje e edukimit gjithëpërfshirës seksual në shkolla për informim më të mirë dhe zvogëlim të paragjykimave midis të rinjve.

**3.** Krijimi i mekanizmave anti-diskriminues dhe mbështetës për viktimat e diskriminimit.

**4.** Mbështetja e iniciativave ekologjike dhe programeve të mbrojtjes së mjedisit që përfshijnë të rinjtë.

**5.** Nxitja e të rinjve për të marrë pjesë në aktivitete që promovojnë përfshirjen sociale dhe njohjen e kulturave dhe identiteteve të ndryshme.


# 8 Qëndrime politike dhe pjesëmarrje politike

Të rinjtë më së shumti ndërtojnë qëndrimet e tyre politike nga ndikimi i prindërve, arsimit, mediave, shoqërisë dhe përvojës personale (Weiss, 2020), por natyrisht duhet marrë parasysh edhe ndikimi i grupit të bashkëmoshatarëve, gjë që mund të çojë në konformizëm për sa i përket sjelljes politike (Mallinson & Hatemi, 2018), sidomos te pulla e re.

Votimi ose dalja në zgjedhje është një nga temat më të rëndësishme në fokusin e shkencave politike. Kjo është mënyra më të cilën qytetarët e kalojnë sovranitetin e tyre tek përfaqësuesit e tyre të ardhëm, dhe në mënyrë që ky proces të jetë demokratik, presupozon përfshirjen aktive të qytetarëve në të (Naumovska et al., 2022). Pikërisht votimi në zgjedhje paraqet një proces kyç të pjesëmarrjes politike, ndonëse ajo njihet edhe për nga format më pak konvencionale, siç është nënshkrimi i peticioneve, pjesëmarrja në protesta dhe forma të tjera të aktivizmit politik. Pjesëmarrja politike nënkupton çdo mënyrë në të cilën qytetarët shprehin qëndrimin e tyre për të ndikuar në procesin e politikëbërjes së qeverisë së tyre (Hague & Harrop, 2007).

Sa i përket pjesëmarrjes politike të të rinjve, literatura shkencore nuk bën dallim midis saj dhe pjesëmarrjes së përgjithshme politike (Weiss, 2020), por tregon më pak interes të të rinjve të BE-së për t'u angazhuar në procesin zgjedhor, krahasuar me grupmoshat e tjera (Barta et al, 2021), përkundër interesimit më të madh për të marrë pjesë në forma jokonvencionale (jo të institucionalizuara) të aktivizmit politik (Pickard, 2019). Sipas sondazheve, në Republikën e Maqedonisë së Veriut të rinjtë nuk e bëjnë praktikë të flasin për zhvillimet politike dhe nuk informohen, as nuk janë të kënaqur me përfshirjen e të rinjve në politikë dhe me mënyrën se si ata konsultohen për vendime të rëndësishme, e megjithatë, paradoksalisht, votojnë në numër të madh (Galevski, 2019, Topuzovska Latkovic et al., 2018/2019). Madje as numri i vogël i kandidatëve të rinj në moshë në listat zgjedhore (Galevski dhe Gjorgievska, 2020) nuk i pengon ata nga votimi. Sondazhet në lidhje me ciklet e fundit zgjedhore flasin për një përqindje të lartë dhe të qëndrueshme të të rinjve që kanë votuar në zgjedhje, e cila është diku rreth 80 % dhe nuk devijon shumë nga pjesëmarrja zgjedhore e grupmoshave të tjera (SSE për Maqedoninë e Veriut, vala e 10-të, 2022; Galevski, Ivanoviq & Jetkoviq Janeva, 2022). Ekzistojnë dallime në raport me grupmoshat e rritura, sa i përket interesit për të ndjekur politikën, gjegjësisht, interesi është më i ulët te popullsia më e re, ku përgjithësisht dominon përgjigja «Nuk jam aspak i interesuar» (53,7 %) (SSE për Maqedoninë e Veriut, vala e 10-të, 2022).

Qëndrimet e të rinjve që i referohen Bashkimit Evropian (BE) gjithashtu tërheqin vëmendjen dhe të dhënat tregojnë një rritje të euroskepticizmit. Në përgjithësi, mbështetja për hyrje në BE nga 80 % në 2014 zvogëlohet në 60 % në 2023, por kur bëhet fjalë për popullsinë prej 18 deri në 29 vjeç, mund të shihet se euroskepticizmi është më së tepërmi i pranishëm, gjegjësisht, nga ky grup i të anketuarve, 53 % e mbështetin këtë proces (Damjanovski, 2023).





Sa i përket kontekstit politik nacional në pesë vitet e fundit, i cili është veçanërisht i rëndësishëm për formimin e personalitetit të të rinjve dhe qëndrimet e tyre, mund të theksohet se, ndonëse Republika e Maqedonisë së Veriut në vitin 2018 ndryshoi emrin kushtetues të vendit, duke nënshkruar Marrëveshjen e Prespës me Republikën e Greqisë për të zgjidhur mosmarrëveshjen 30-vjeçare të emrit, hyrja në BE përsëri pengohet. Një përfitim i rëndësishëm nga ndryshimi i emrit është anëtarësimi në NATO, i cili është i një rëndësie të veçantë për sigurinë nacionale, veçanërisht gjatë periudhës së veprimeve ushtarake në tokën evropiane.

Kjo gjendje e mungesës së konsistencës së politikave të BE-së ndaj vendit pa dyshim që ka ndikuar që besimi i qytetarëve në qeverinë e mëparshme, të udhëhequr nga partia politike LSDM, të pësojë rënie.

## 17% e popullsisë së re është e interesuar për politikën

Në momentin e përgatitjes së kësaj analize, vendi ndodhet në një periudhë paszgjedhore ku ka përfunduar votimi për përbërjen e re parlamentare,<sup>4</sup> por Qeveria ende nuk është formuar. Për momentin, qytetarët maqedonas po presin qeverinë e re të koalicionit, të udhëhequr nga VMRO-DPMNE, në të cilën do të marrin pjesë koalicioni Vlen dhe partia ZNAM. Për herë të parë në më shumë se 20 vjet, partia BDI duhet të tërhiqet nga pushteti ekzekutiv.

## Interesi për politikë dhe përfaqësimi

Në vitet e fundit, në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë bërë një sërë studimesh mbi rininë dhe politikën, dhe te të gjitha këto, narrativa mbizotëruese është se të rinjtë kanë një shkallë të ulët besimi tek institucionet politike dhe pak interes për proceset politike.

Kjo narrativë konfirmohet edhe nga rezultatet e dy studimeve të fundit mbi të rinjtë nga ana e Fondacionit Friedrich Ebert, që tregojnë një përqindje të ulët të interesit për politikën midis të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në vitin 2018 kjo përqindje ishte 16,8%, ndërsa në 2024 17%, gjë që tregon se ekziston një hendek mes rinisë dhe politikës.

Interesi i ulët për politikë tek të rinjtë është për shkak të kontekstit politik dhe serisë së krizave intensive politike që vendi ka kaluar në 10 vjetët e fundit, si dhe për shkak të mosbesimit tek partitë politike dhe institucionet, të cilat nuk kanë arritur të gjejnë një zgjidhje për problemet e korrupsionit, sundimit të ligjit, sistemit shëndetësor dhe cilësisë së arsimit.

Interesi për politikë është i lidhur ngushtë me përfaqësimin e të rinjve në proceset politike. Një tregues tjetër dhe njëkohësisht arsye për interesin e ulët për politikë është fakti se vetëm 9% e të anketuarve besojnë se interesat e tyre përfaqësohen mjaft mirë ose shumë mirë në politikën nacionale. Në studimet e mëparshme, kjo përqindje ishte rreth 20% dhe rekomandimet tregojnë domosdoshmërinë e përfshirjes më të madhe të të rinjve në proceset e vendimmarrjes, sidomos në nivel lokal dhe për temat që u interesojnë.

Në zgjedhjet e fundit lokale, vetëm 2,99% të kandidatëve për kryetar komune ishin të rinj, sipas përcaktimit ligjor të moshës 18–29 vjeç, pra vetëm 9 kandidatë nga gjithsej 301. Në përbërjen e fundit parlamentare 2020–2024 kishte vetëm katër deputetë nën moshën 30 vjeç (3,33% e deputetëve).

Mungesa relative e të rinjve në politikë dhe në proceset politike është shqetësuese jo vetëm në aspekt të kujdesit normativ për angazhimin qytetar, por edhe për shkak se të rinjtë kanë preferenca të ndryshme për një gamë të gjerë politikash që i prekin ata drejtpërdrejt, përkatësisht ato që lidhen me arsimin, papunësinë, teknologjitë më të reja, por edhe për çështje afatgjata siç janë ndryshimet klimatike.

Fig. 19 Përfaqësimi i interesave të të rinjve në politikë (in %)





Fig. 20 Pozicionimi ideologjik mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)

Kur njerëzit flasin për bindjet e tyre politike, ata kryesisht flasin për krahun e majtë dhe të djathtë. Në përgjithësi, si do të ishin pikëpamjet tuaja në këtë shkallë? Përgjigjet në një shkallë nga 1 në 10 grupohen: majtas (1–4), në qendër (5–6) dhe 7–10 djathtas



## Orientimet ideologjike

Është e rëndësishme të theksohet se Republikën e Maqedonisë së Veriut vazhdon të mungojë një qasje sistematike dhe e organizuar për organizimin e arsimit politik në frymën e vlerave demokratike nga ana e institucioneve shtetërore, ndërkohë që qëndrimet, perceptimet dhe interesi i ulët i të rinjve për proceset politike tregojnë nevojën për të përfshirë arsimin politik, sidomos në shkollat e mesme (Damjanovski, Markoviç, Spasov 2023).

Një argument tjetër që konfirmon të lartpërmendurat janë rezultatet nga shqyrtimi i orientimeve ideologjike të të rinjve në vend. Sipas Studimit për të rinjtë 2013, 38 % nuk kanë ditur të pozicionohen në shkallën ideologjike nga e majta në të djathtë (Topuzovska Latkoviç etc 2013,105), në vitin 2018 kjo përqindje ishte pothuajse 50 % e atyre që u përgjigjën me «nuk e di» ose «nuk dua të jap përgjigje» (Topuzovska Llatkoviç etc. 2019,77), ndërsa në studimin aktual këtë vit 39 % e të anketuarve zgjedhën përgjigjet e njëjta. Analiza krahasuese e 12 vendeve të rajonit tregon se kjo shkallë e të anketuarve që nuk dinë/duan të pozicionohen ideologjikisht është më e larta në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Fig. 21 Qëndrimet e definuara ideologjikisht mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut

Vlerat mesatare në një shkallë nga '1 – aspak dakord' në '5 – plotësisht dakord'



Nga përgjigjet e atyre subjekteve që vendosën të pozicionohen ideologjikisht, në një shkallë nga 1 në 10, nga e majta ekstreme në të djathtë ekstreme, mesatarja e të gjitha subjekteve është në qendër me vlerën  $m=5,24$ .

Në variablën e grupuar 1–4 majtas, 5–6 qendër dhe 7–10 djathtas, 35,3 % u përcaktuan për të majtën, 33,8 % për qendrën dhe 30,9 % për të djathtën. Krahasuar me rezultatet nga studimi i vitit 2018, nuk janë evidentuar ndryshime të dukshme në pozicionimin ideologjik të të rinjve në vend. Të dhënat tregojnë se ekziston një lidhje mes pozicionimit ideologjik dhe shumës së të ardhurave familjare, me një rëndësi të lartë statistikore të nivelit 0,05. Gjegjësisht, të rinjtë që janë të orientuar nga e majta vijin nga familje me të ardhura më të larta, gjë që është interesante për t'u theksuar, duke qenë se e majta synon ideologjikisht të mbështesë familjet që punojnë dhe të drejtat e tyre.

Me pyetjen për (mos)pajtimin me deklarata të caktuara ideologjike, patëm mundësinë të definojmë më hollësisht përcaktimin e deklaruar në pyetjen e mëparshme. Nga rezultatet e marra, mund të arrihet në përfundimin se të rinjtë kanë qëndrime më të shprehura majtiste, përkatësisht ata besojnë se të ardhurat e të pasurve dhe të varfëve duhet të jenë më të barabarta ( $m=3,57$  në një shkallë prej 1–5) dhe se qeveria duhet të marrë më shumë përgjegjësi për të siguruar që të gjithëve t'u jepet kujdesi i nevojshëm (mesatarja e lartë  $m=4,25$ ), si dhe se pronësia shtetërore e biznesit dhe industrisë duhet të rritet ( $m=3,05$ ).

Nuk janë evidentuar dallime të rëndësishme statistikore për sa i përket gjinisë, vendbanimit dhe nivelit të arsimit. Poashtu, nuk është vërtetuar një korrelacion i rëndësishëm statistikor midis pozicionimit në shkallën majtas-djathtas dhe tri deklaratave ideologjike.

E vetmja gjë e konstatuar ishte se statusi social i të anketuarve, apo të ardhurat në familje, është në korrelacion negativ me deklaratën se shteti duhet të rrisë pronësinë shtetërore të biznesit dhe industrisë. Gjegjësisht, të anketuarit nga familjet me të ardhura më të ulëta pajtohen më shumë me këtë deklaratë, krahasuar me të anketuarit që kanë familje me të ardhura më të larta. Situata ndryshon kur bëhet fjalë për qëndrimin se shteti duhet të kujdeset për të gjithë qytetarët, domethënë shumica e të anketuarve që pajtohen me këtë qëndrim vijin nga familje me të ardhura më të larta.

## Votimi dhe qëndrimet për partitë politike

Nga format e pjesëmarrjes politike, votimi në zgjedhje është forma më e zakonshme, fakt që e tregojnë dhe të dhënat nga ky sondazh. Sipas përgjigjeve të pyetjes «A keni votuar në zgjedhjet e fundit parlamentare?», 46,8 % e popullsisë së anketuar janë përgjigjur pozitivisht, 11,4 % janë përgjigjur se nuk kanë votuar edhe pse kanë të drejtë vote, ndërsa 37,4 % në atë kohë nuk kanë pasur ende të drejtë vote (4,4 % nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje). Nëse marrim në konsideratë vetëm të anketuarit që kanë pasur të drejtë vote, rezulton se në zgjedhjet e fundit parlamentare kanë votuar 80,3 %.

Nga të anketuarit që kanë pasur të drejtë vote, në zgjedhjet e fundit parlamentare të mbajtura në vitin 2020, më së shumti kanë votuar për koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE (24,4 %), e më pas sipas votave vijojnë: Koalicioni i udhëhequr nga LSDM (17,2 %); Levica (10,4 %); BDI (9,6 %) dhe Aleanca për Shqiptarët (3,2 %). Më pak se 1 % e popullsisë së anketuar kanë votuar për partitë e tjera politike. 26,6 % nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje dhe 6 % u përgjigjën «nuk e di».

Në lidhje me pyetjen «Nëse do të ketë zgjedhje parlamentare në ditët në vijim, për cilën parti do të votonit?», edhe pse sondazhi është kryer pak para zgjedhjeve, dominojnë përqindjet e përgjigjeve «nuk e di» dhe «nuk kam përgjigje» nga pothuajse gjysma e të anketuarve (ose më saktë 45,3%). Midis të anketuarve që dhanë një përgjigje specifike për këtë pyetje, partia më e përmendur është VMRO-DPMNE (për të cilën do të votonin 15,3%), më pas Levica (për të cilën do të votonin 12,4%), BDI (për të cilën do të votonin 8,9%), LSDM (për të cilën do të votonin 6,1%) Aleanca për Shqiptarët (për të cilën do të votonin 3%) dhe Lëvizja Besa (për të cilën do të votonin 2,5%). Partitë e tjera përmenden me më pak se 1%, ndërsa 6% janë përgjigjur se do të votonin për ndonjë parti tjetër.

Në krahasim me rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, tendenca për të mbështetur VMRO-DPMNE-në vihet re edhe tek të rinjtë, por ajo që bie më së shumti në sy është mbështetja për Levicën, e cila dukshëm mori pjesën më të madhe të votave të saj nga popullsia e re (votat e marra sipas rezultateve përfundimtare 6,82%, burimi KSHZ).

**80%** e të rinjve që kishin të drejtë vote, ka votuar në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2020

Sipas përgjigjeve të dhëna ndaj pyetjes «A do të pranoni funksione politike?», më shumë se gjysma e të anketuarve u përgjigjën se nuk do ta pranoni një funksion të tillë (ose më saktë 57,2% e popullsisë së anketuar), ndërsa 22,2% iu përgjigjën po kësaj pyetjeje pozitivisht. 18,5% nuk kanë ditur t'i përgjigjen kësaj pyetjeje dhe 2,1% nuk janë përgjigjur. Sa i përket nëngrupeve të rritura nuk vihet re ndonje dallim i rëndësishëm statistikor në përgjigjet e tyre, por ekzistojnë dallime kur pyetja shqyrtohet nga pikëpamja e gjinisë. Djemtë do të pranoni poste politike dy herë më tepër (30,2%) se vajzat (16,5%) (rëndësia statistikore 0,001).

Ndaj të njëjtës pyetje në Studimin nacional për gratë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Topuzovska Latkoviq dhe të tjera, 2021), realizuar nga Fondacioni Friedrich Ebert, 65% e grave u përgjigjën negativisht, pra se nuk do të pranoni funksione politike, ndërsa vetëm 7% u përgjigjën pozitivisht. Si arsye për mospranimin e funksioneve politike, ato përmendën mosbesimin ndaj partive politike dhe mënyrën e funksionimit të tyre, mungesën e ideologjisë dhe vlerave të qarta, diskriminimin, si dhe faktin se nuk besojnë se mund të ndryshojnë diçka në vend.

Sipas hulumtimit cilësor «Si mund të sigurohet përfaqësim i barabartë dhe i drejtë në Kuvend», faktorët kryesorë që ndikojnë në kandidaturën e pamjaftueshme të grave për poste politike janë mentaliteti tradicional patriarkal, si dhe mungesa e vullnetit të vetë grave për shkak të trajtimit shoqëror që nënkupton marginalizimin, diskriminimin, mungesën e respektit dhe fjalorin e pahijshëm drejtuar grave të ekspozuara, si dhe mungesën e mbështetjes nga familja (Naumovska et al., 2022).


Sipas një studimi tjetër që fokusohet te gratë në përgjithësi, përgjegjësitë shtëpiake dhe kujdesi familjar janë nga faktorët kryesorë që ndikojnë që gratë të mos angazhohen në pozita më të larta (Atansov; Naumovska, 2013).

Të dhënat tregojnë nevojën për të përfshirë më shumë gra dhe vajza në poste drejtuese, në mënyrë që të rritet besimi i grave në politikë dhe, në të njëjtën kohë, t'i motivojë ato që të përfshihen më aktivisht në proceset politike. Gjithashtu, ekziston nevoja për të rritur ndërgjegjësimin e vendimmarrësve rreth përfitimeve nga përfshirja e grave në proceset vendimmarrëse.

Qëndrimi ndaj partive të caktuara politike, pra ndjenja që kanë ndaj tyre, u shpreh nga të anketuarit në një shkallë prej 10 pikësh (1 – nuk më pëlqen aspak kjo parti dhe 10 – më pëlqen shumë kjo parti).

Fig. 22 **Ndjenjat ndaj partive politike mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut**

*Vlerësin mendimet tuaja për partitë kryesore politike në maqedoninë e veriut në një shkallë nga 0 deri në 10, ku 0 do të do të do të thotë që nuk të pëlqen fare ajo parti dhe 10 do të do të do të thotë të pëlqen shumë ajo parti.*



Nga vlerat mesatare të rezultuara, mund të vihet re se asnjë nga partitë e përmendura nuk e kalon mesataren 5, gjë që nënkupton një prirje drejt ndjenje/qëndrimi pozitiv. Sipas vlerave mesatare të shfaqura, partia VMRO-DPMNE ka vlerën më të lartë mesatare ( $m=3,93$ ) ndërsa partia Aleanca për Shqiptarët ka më të ultën ( $m=2,07$ )<sup>5</sup> Devijimi standard varion nga 2,025 deri në 3,089, pjesërisht për shkak të madhësisë së shkallës, por supozohet se kjo është edhe për shkak të strukturës etnike të të anketuarve. Sipas korrelacionit bivariant, rezultoni se të rinjtë që kanë ndjenja më pozitive ndaj partive politike VMRO-DMNE, BDI dhe Aleanca për Shqiptarët pozicionohen më djathtas në boshtin ideologjik.

Përveç qëndrimit/ndjenjës së tyre rreth partive politike të listuara, të anketuarit, në një shkallë prej katër nivelesh, u pyetën: «A ju pëlqen të keni miq të ngushtë që janë përkrahës të një partie?» (për çdo parti parashtrohet pyetje e veçantë). Ajo që bie më shumë në sy në lidhje me këtë pyetje është përqindja e lartë e të anketuarve që nuk iu përgjigjën pyetjes. Kjo përqindje varion nga 52% që nuk iu përgjigjën pyetjes që lidhet me miqësitë e ngushta me përkrahësit e BDI-së, deri në 74% që nuk iu përgjigjën nëse do të ndiheshin mirë të kishin miq të ngushtë që janë përkrahës të Levicës. Nga përgjigjet e dhëna, ka vetëm një qëndrim pozitiv dhe ai është ndaj përkrahësve të partisë LSDM, me vlerat mesatare si në vijim: LSDM  $m=2,23$ ; VMRO-DPMNE  $m=1,86$ ; BDI  $m=1,8$ ; Levica  $m=1,58$  dhe Aleanca për Shqiptarët  $m=1,85$ .

7,2% e të anketuarve janë të përfshirë aktivisht në jetën politike nëpërmjet anëtarësimit në një parti politike dhe 13,8% do të donin të anëtarësohen, ndërsa 61,3% nuk do të donin të përfshihen në këtë formë aktivizmi. Pothuajse një në dy të anketuar nuk është përgjigjur ose nuk ka ditur se si t'i përgjigjet kësaj pyetjeje (ose më saktë 17,6%). Nuk janë vënë re dallime në përgjigje sipas gjinisë dhe moshës. Siç edhe pritet, të rinjtë e interesuar për politikë kanë shumë më shumë gjasa të jenë anëtarë të një partie politike ose të mendojnë që të bëhen pjesë e një partie (rëndësia statistikore  $p<0,001$ ).

Të anketuarit që janë apo që do të ishin bërë anëtarë të partive politike u pyetën për arsyet e tyre për t'u bërë pjesë e partive. Sipas përgjigjeve, diçka pozitive që mund të vihet re është se arsyeja më e shpeshtë për aktivizmin në një parti politike është nevoja për të ndikuar në drejtim të përmirësimit të shoqërisë (53,5%), pas së cilës vjen punësimi personal ose punësimi i një anëtari të familjes (27,7%) dhe përfitimet personale dhe materiale (10,8%).


## Besimi në institucione

Kur bëhet fjalë për besimin në institucione të ndryshme politike, popullsia e anketuar shprehu nivelin e besimit në një shkallë me 5 nivele (1 – nuk u besoj aspak, 3 – u besoj disi, dhe 5 – u besoj plotësisht).

Fig. 23 Besimi në institucione mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut

*Në përgjithësi, sa besoni te subjektet e renditura më poshtë?*

Vlerat mesatare në një shkallë nga '1 – aspak' në '5 – plotësisht'



Sipas përgjigjeve të dhëna, të rinjtë, në përgjithësi, kanë pak besim te të gjitha institucionet e ofruara, pasi vlerat mesatare të përgjigjeve ndodhen nën nivelin e shkallës neutrale. Niveli më i lartë i besimit është ndaj organizatave fetare ku ata përkasin (m=3,18), më pas ndaj Ushtrisë (m=3,02). Popullsia e anketuar ka shprehur nivelet më të ulëta të besimit për Partitë politike (m=1,86), Qeverinë (m=1,93) dhe Kuvendin (m=2,00), mes «nuk u besoj aspak» dhe «u besoj pak». Gjendja e besimit në institucione mbetet e pandryshuar, krahasuar me të dhënat nga studimi i vitit 2019.

Ndaj pyetjes «A mendoni se kishat dhe organizatat fetare në këtë shtet kanë pushtet të tepërt apo të pamjaftueshëm?», të anketuarit e vlerëuan nivelin e pushtetit të këtyre organizatave në një shkallë prej 5 pikësh, ku 1 do të thotë «jashtëzakonisht pak pushtet» dhe 5 do të thotë «jashtëzakonisht shumë pushtet». Sipas përgjigjeve të mblidhura, vlera mesatare e përgjigjeve të dhëna për këtë pyetje është m=2,96, gjegjësisht të anketuarit besojnë se organizatat fetare kanë mjaft pushtet në shtet.

## Aktivizmi politik

Grupi tjetër i pyetjeve u kushtohet formave të ndryshme të aktivizmit politik dhe asaj se deri në ç'masë të rinjtë kanë marrë pjesë në procese të tilla apo kanë një qëndrim pozitiv ndaj tyre. Sipas përgjigjeve, të rinjtë më së shumti kanë ndaluar së bleri gjëra për arsye politike ose mjedisore (23,6%) dhe kanë qëndrimin më pozitiv ndaj kësaj forme të aktivizmit politik ende jo, por do të doja (14,9%), 22,3% kanë qenë vullnetarë ose kanë marrë pjesë në aktivitete të organizatave civile, 18,4% kanë nënshkruar një listë kërkesash politike/kanë mbështetur një peticion online, 16,5% kanë marrë pjesë në një demonstratë dhe 13,2% kanë marrë pjesë në aktivitete politike në rrjetet sociale. Interesi më i vogël për përfshirje evidentohet të jetë ai në raport me angazhimin në një parti politike apo grup politik (9,5%).

Pritet një përfshirje më e madhe e rinisë në forma të ndryshme të aktivizmit politik ose forma të ndryshme të pjesëmarrjes politike nëse rinia fiton njohuri të përshtatshme për rëndësinë e këtyre proceseve dhe për mekanizmat e kontrollit që mund të përdorin, si dhe nëse rritet përfaqësimi i tyre në proceset vendimmarrëse. Nevoja për arsim politik<sup>6</sup> për të rinjtë është imponuar prej kohësh në diskutime të ndryshme politiko-shoqërore dhe shkencore, me qëllim që të rinjtë të fitojnë njohuri për karakteristikat e sistemeve politike demokratike dhe rolin e qytetarëve brenda tyre, për karakteristikat e institucioneve politike dhe rolin e tyre, për ideologjitë e ndryshme dhe mënyrat e tyre për të zgjidhur problemet sociale.

Në këtë mënyrë, rinia do të jetë në gjendje të adoptojë një qëndrim të informuar, të pozicionohet ideologjikisht dhe të përdorë efektivisht të drejtën e votës dhe të drejtën për të marrë pjesë në nisma të ndryshme politike.

## Sindikalizmi

Sipas distribuimit të përgjithshëm të përgjigjeve, 5,2% e të anketuarve janë anëtarë të një sindikate, 12,7% do të donin të anëtarësohen, dhe 82,1% thanë se nuk janë anëtarë. Nëse e marrim këtë pyetje nga aspekti i statusit të punës, nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 18,6% thanë se janë punëtorë të përhershëm me kohë të plotë, nga të cilët 15,2% janë anëtarë të një sindikate dhe 10,9% do të donin të anëtarësohen. Mund të konkludohet se sindikalizmi si mekanizëm për veprim të organizuar dhe të bashkuar, që lidhet me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe përmirësimin e kushteve të punës, nuk është i pranishëm tek të rinjtë.

## Vlerat demokratike dhe autoritare


Me qëllim që të shqyrtohen vlerat demokratike dhe autoritare të të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, atyre iu dhanë tetë deklaratat lidhur me qeverisjen demokratike, pjesëmarrjen e të rinjve në politikë dhe të drejtat qytetare.

Gjatë analizës së këtyre të dhënave, duhet patur parasysh se demokracia maqedonase është relativisht e re dhe e pakonsoliduar. Raportet e Freedom House në vitet e fundit shënojnë një zbramsje në demokraci dhe tregojnë se regjimi hibrid është forma më mbizotëruese e qeverisjes në rajonin që mbulon raportin. Regjime të tilla kombinojnë elemente të sundimit demokratik dhe autoritar (FH Report, 2022, 2023), gjë e cila pasqyrohet në rezultatet e hulumtimit në këtë pjesë.

Nga të dhënat e përfuara, mund të konkludohet se në mesin e të rinjve mbizotërojnë qëndrimet demokratike. Shumica, ose 59,3% e të anketuarve, janë dakord se demokracia është një sistem i mirë qeverisjeje dhe se në çdo rrethanë ajo është më e mirë se çdo sistem tjetër qeverisjeje (53,2%). Megjithatë, një e katërta e të anketuarve (23%) preferojnë diktaturën në disa rrethana.

Fig. 24 Vlerat demokratike kundrejt autoritare mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)

Përqindja kumulative e të rinjve që u përgjigjën 'Kryesisht dakord' dhe 'Jam shumë dakord' për pohimet e mëposhtme:



Të rinjtë që janë më pro diktaturës janë të pozicionuar më nga e djathta në shkallën ideologjike ( $r=,121$ ,  $p<0,05$ ); në shumicën e rasteve konsiderojnë se burrat kanë më shumë gjasa të jenë udhëheqës më të mirë politikë se gratë ( $r=,195$ ,  $p<0,01$ ), kanë interes më të madh për politikën ( $r=,131$ ,  $p<0,01$ ), dhe janë më pak dakord se demokracia është një formë e mirë e qeverisjes ( $r=-,196$ ,  $p<0,05$ ). Qëndrimi i pajtimit është më i pranishëm midis anëtarëve të popullsisë së re mashkullore (27,3% përkundër 19,6%,  $\chi^2=10,168$ ,  $p<0,05$ ) dhe të anketuarve që e plotësuan sondazhin në gjuhën shqipe (35% përkundër 19,6%,  $\chi^2=27,022$ ,  $p<0,01$ ).

Nuk vihen re dallime të rëndësishme statistiko-re sipas grupmoshës dhe statusit socio-ekonomik (niveli i arsimimit të të rinjve dhe prindërve të tyre, vendi i banimit, gjendja financiare).

Përgjigjja me përqindjen më të lartë (68%) përsërit nevojën për përfshirje më të madhe të të rinjve në politikë, ku të anketuarit janë dakord me deklaratën se rinia duhet të ketë më shumë mundësi për të pasur një zë në politikë.

Për 36% standardi i jetesës është më i rëndësishëm se liria civile, ndërsa 29,4% preferojnë të drejtat dhe lirinë përkundër një standardi më të lartë. Një përqindje e ngjashme ekziston edhe për deklaratat për kufizimin e lirive qytetare për shkak të mbrojtjes më të madhe nga rreziqet e sigurisë.

Përqindja e mbështetjes për vlerat demokratike dhe qeverisjen është më e lartë në studimet e mëparshme, në të cilat ka ambivalencë në qëndrime, gjë që nuk hasset në këtë studim.

## Vlerat më të rëndësishme

Të rinjtë që ishin pjesë e këtij sondazhi renditën kategoritë e përmendura sipas asaj që konsiderojnë se janë vlera më të rëndësishme për ta personalisht. Sipas përgjigjeve të dhëna, rinia theksoi si vlera më të rëndësishme: 1) të drejtat e njeriut, 2) mirëqenien ekonomike të qytetarëve dhe 3) sigurinë. Për dallim nga të dhënat në Studimin për të rinjtë 2018/19, në këtë hulumtim del se siguria është një nga vlerat më të rëndësishme në mes të rinjve. Ky ndryshim supozohet se ka ndodhur për shkak të ndryshimit të rrethanave në Evropë dhe më gjerë, më saktë për shkak të luftërave në Ukrainë dhe në Lindjen e Mesme.



Fig. 25 Vlerat më të rëndësishme për të rinjtë në Maqedoninë e Veriut (in %)

	Rangu i parë	Rangu i dytë	Rangu i tretë	Në total të përmendura si një nga tri vlerat më të rëndësishme
Demokracia				14,5
Sundimi i ligjit				34,6
Të drejtat e njeriut	19,8	15,5	16,1	51,4
Mirëqenia ekonomike e qytetarëve	13,6	18,5	17,6	49,7
Punësimi				40,4
Barazia sociale				24,1
Barazia gjinore				15,1
Siguria	15,1	17,6	14,9	47,6
Liria individuale				22,5

Gjithashtu, të rinjve iu kërkua që të vlerësojnë statusin e këtyre nëntë vlerave në Maqedoninë e Veriut dhe në Bashkimin Evropian në shkallë prej 1 deri në 5 (1 – shumë keq dhe 5 – shumë mirë). Sipas analizës, vlerësimi i gjendjes për të gjitha vlerat është më i lartë kur bëhet fjalë për Bashkimin Evropian sesa për Maqedoninë e Veriut. Thënë ndryshe, të gjitha vlerat për vendin janë në intervalin negativ të boshtit, dhe të gjitha vlerat për BE-në kanë një vlerë mesatare pozitive, e cila shkon nga mirë (3) deri në shumë mirë (4). Dallimi më i madh mund të vihet re te vlera Mirëqenia ekonomike e qytetarëve. Kjo vlerë ka rezultatin më të lartë kur bëhet fjalë për BE-në (m=3,58) dhe rezultatin më të ulët për Maqedoninë e Veriut (m=1,78). Sundimi i së drejtës në vend vlerësohet ulët me m=1,81, përkundër BE-së me m=3,22. Dallimi më i vogël mund të vihet re te vlerat e Sigurisë dhe Lirisë individuale.

## Qëndrimi ndaj BE-së


Për sa u përket pyetjeve që lidhen me pranimin e vendit në Bashkimin Evropian, ashtu si edhe në hulumtimet e tjera (Damjanovski, 2023), edhe në këtë hulumtim mund të shihet trendi i rritjes së euroskepticizmit. Sipas përgjigjeve të dhëna, 41,7% e të anketuarve besojnë se vendi duhet të anëtarësohet në Bashkimin Evropian (BE), ndërsa 37,9% nuk konsiderojnë se kjo duhet të ndodhë (gjithsej 20,4% nuk kanë ditur ose nuk i kanë dhënë përgjigje pyetjes).

Krahasimisht, në Studimin për të rinjtë të vitit 2013, 73% treguan qëndrim favorizues ndaj hyrjes në BE (Topuzovska Llatkoviç et al 2013), ndërsa në Studimin për të rinjtë 2018/2019 (Topuzovska Llatkoviç et al, 2018/2019) deri në 81% e të rinjve kanë mbështetur anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Fig. 26 **Gjendja e perceptuar e vlerave në vendin e tyre dhe në BE mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut**

*Sipas mendimit tuaj, sa mirë apo keq ndiqen vlerat e renditura në vendin tuaj dhe në be?*

Vlerat mesatare në një shkallë nga '1 – shumë keq' në '5 – shumë mirë'



Mund të vihen re dallime të rëndësishme nëse të dhënat shqyrtohen nga pikëpamja e grupmoshave. Kështu, qëndrimin më pozitiv kanë të anketuarit e grupmoshës së mesme 25 deri në 29 vjeç (46,2%), më së shumti përgjigje negative ka te të anketuarit e moshës 19 deri në 24 vjeç (44,9%), ndërsa, më së shumti, të anketuarit e moshës 14 deri në 18 vjeç (32,2%) nuk kanë ditur ose nuk kanë pasur përgjigje për këtë pyetje.

Me ndryshimin e rrethanave lidhur me pranimin e vendit në Bashkimin Evropian dhe futjen e kuartit negociues të propozuar nga Franca si kusht për vazhdimin e procesit, të rinjtë u pyetën nëse e mbështesin apo e kundërshtojnë këtë proces. Sa u përket përgjigjeve, fillimisht duhet përmendur fakti se pothuajse një e treta e të anketuarve nuk dinin/nuk kishin një përgjigje për këtë pyetje (më saktë 31,7%).

Nga të anketuarit që dhanë një përgjigje konkrete, opinioni është i ndarë, gjejmë 50,1% e mbështesin këtë proces (25% plotësisht dhe 25,1% pjesërisht), kurse 49,9% e kundërshtojnë atë (19,7% pjesërisht dhe 30,3% plotësisht). Sipas analizës bivariante, të rinjtë që nuk mbështesin kuartin negociues të propozuar nga Franca kanë më pak gjasa të identifikohen si qytetarë të Evropës ose evropianë ( $r=-,325$ ,  $p<0,01$ ). Megjithatë, besimi në BE mbetet i pandryshuar nga Studimi për të rinjtë 2018/2019 ( $m=2,71$ ,  $m=2,72$ ).

Të rinjtë ndihen më shumë si maqedonas ( $m=3,71$ ) sesa si evropianë ( $m=2,94$ ). Për herë të parë gjatë zbatimit të studimeve longitudinale për të rinjtë, që nga viti 2013, identifikimi me Evropën ka një vlerë mesatare më pak se 3, gjejmë ndodhet në intervalin negativ të boshtit. Identifikimi me identitetin nacional është ulur gjithashtu (nga  $m=4,12$  në 2018/2019).

Të dhënat lidhur me Bashkimin Evropian dhe ndryshimet e detektuar në qëndrimet e të rinjve ndaj tij supozohet të jenë pasojë e politikës së Bashkimit Evropian (BE) ndaj Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke qenë se pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespës me Republikën e Greqisë dhe ndryshimit të emrit kushtetues të vendit në vitin 2018, shumica e qytetarëve, veçanërisht popullsia e re, prisnin zhbllokimin e rrugës për integrimin euro-atlantik dhe fillimin e papen-guar të negociatave për pranim në BE, gjë e cila në mënyrë të papritur u problematizua sërish me kërkesat dhe veton nga ana e Republikës së Bullgarisë për ndryshimet e reja kushtetuese.

## Informimi mediatic

Nga pyetjet që lidhen me informimin e të rinjve prej mediave maqedonase në lidhje me politikën dhe ngjarjet aktuale, rezulton se shumica e të rinjve nuk i ndjekin mediat, edhe pse kjo pyetje i referohet edhe përmbajtjes së pranishme në hapësirën online, por të prodhuar nga mediat. Sipas përgjigjeve të dhëna, televizioni Sitel është më i ndjekuri (47,5%), më pas vijnë Kanal 5 (41,3%) dhe Telma (31,6%). Sa u përket TV24, Alsat dhe Alfa, më shumë se 70% e të anketuarve u përgjigjën se nuk kishin kohë për t'i ndjekur. Pyetja kishte të bëjë me kohën e kaluar në bazë javore për të ndjekur përmbajtje që lidhen me politikën dhe temat aktuale. Nga të dhënat, mund të vihet re se një përqindje shumë e vogël e të anketuarve (1,7% deri në 3,2%) shpenzojnë më shumë se 5 orë në javë, duke ndjekur përmbajtje politike dhe aktuale.

Si rezultat i përdorimit të teknologjive të reja, ndryshimet më të mëdha, në përgjithësi në të gjithë popullsinë, mund të vihen re në raport me burimin e informimit të tyre, duke qenë se interneti dhe rrjetet sociale zënë vendin e parë si mjete për informim. Sipas sondazhit të Eurothink (2023) për tema politike, qytetarët informohen më shpesh nëpërmjet internetit (56,5%), dhe kjo prirje është veçanërisht e dukshme te popullsia më e re.

Përderisa në vitin 2014, për ngjarjet vendore dhe të huaja, 84,35% e të rinjve çdo ditë ose disa herë në javë kanë ndjekur televizionet, 19% shpesh në televizion kanë ndjekur përmbajtje politike dhe më shumë se 1/3 kanë kaluar më shumë se 2 orë duke ndjekur televizione (ASHMAA, 2014), të dhënat nga viti 2022 thonë se 70% e të rinjve informohen nga rrjetet sociale, 19% nga portalet e internetit dhe 8,2% nga burime të tjera (Agjencia për rini dhe sport, 2022).

## Qëndrime për barazinë gjinore

Në vitin 2022, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi Strategjinë nacionale për barazi gjinore, pas së cilës vijuan konkluzionet, me të cilat Kuvendi u angazhua të miratojë ligjin për barazi gjinore dhe të themelojë Sekretariatit për barazi gjinore deri në fund të vitit 2023. Projektligji për barazinë gjinore ka një rëndësi të madhe, jo vetëm sepse forcon mekanizmat institucionalë për barazinë mes grave dhe burrave, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, por edhe për shkak të mesazhit të vlerës që mbart.

Procesi u pengua nga dezinformatat gjinore, të cilat u plasuan në publik dhe provokuan reagime të dhunshme, si dhe nga përfshirja e institucioneve fetare dhe ndikimi i fortë i lëvizjeve antigjinore në vend.

Për të vlerësuar qëndrimin e popullsisë së re në lidhje me këtë temë, u parashtrua pyetja: «A e mbështesni nismën për një Ligj për barazinë gjinore?» Ndaj kësaj pyetjeje, 47,4% u përgjigjën pozitivisht dhe 26,3% u përgjigjën se nuk e mbështesin. Pjesa e mbetur prej 28,3% nuk u përgjigj ose nuk dinte si t'i përgjigjej kësaj pyetjeje. Sa i përket gjinisë, ekziston një dallim i pjesshëm midis vajzave dhe djemve, ku vajzat janë 6% më të priura për të mbështetur nismën sesa djemtë (50% përkundër 43,9%). Krostabulacioni sipas pozicionimit të grupuar ideologjik tregon se të rinjtë që pozicionohen në qendër me përqindjen më të lartë (61,5%) e mbështesin Ligjin për barazi gjinore, në krahasim me të rinjtë me orientim ideologjik të majtë (48,6%) dhe të djathtë (43,6%). Megjithatë, nuk janë evidentuar dallime të rëndësishme statistikore sipas testit Hi-katror.

## Vëzhgime përmbyllëse

**1.** Të rinjtë kanë pak interes për politikën dhe proceset politike në vend (17%), gjë që lidhet ngushtë me përfaqësimin e ulët të të rinjve në politikë. Vetëm 7% besojnë se interesat e tyre përfaqësohen në proceset politike.

**2.** Një përqindje e lartë prej 39% e të anketuarve nuk dinë ose nuk duan të pozicionohen ideologjikisht. Pjesa tjetër është 35,3% për të majtën, 33,8% për qendrën dhe 30,9% për të djathtën.

**3.** Shumica, ose 59,3% e të anketuarve, pajtohen se demokracia është një sistem i mirë qeverisjeje dhe se në çdo rrethanë ajo është më mirë se çdo sistem tjetër qeverisjeje (53,2%). Megjithatë, një e katërta e të anketuarve (23%) preferojnë diktaturën në disa rrethana të caktuara.

**4.** Nga të rinjtë që kanë të drejtë vote, në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2020, kanë votuar 80,3%. Sipas këtij sondazhi, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja mori më shumë besim nga të rinjtë në zgjedhjet e përmendura, ndërsa sa i përket votimit për zgjedhjet e ardhme, pothuajse gjysma e popullsisë së anketuar «nuk e dinte» ose «nuk kishte një përgjigje» për këtë pyetje.

**5.** Pothuajse dy herë më shumë djem (30,2%) se vajza (16,5%) do të pranonin një funksion politik. Në përgjithësi, në mesin e të rinjve, nuk ekziston një qëndrim pozitiv për partitë politike, megjithkëtë, vlera më e lartë mesatare e partive të anketuara është dhënë për VMRO-DPMNE  $m=3,93$ . Për të rinjtë, më të pranueshëm si miq janë mbështetësit e LSDM-së, në krahasim me mbështetësit e partive të tjera.

**6.** Nga të anketuarit e rinj, 21% janë anëtarë ose do të donin të bëheshin anëtarë të një partie politike të caktuar dhe si arsye më të zakonshme për t'u bashkuar, theksojnë nevojën për të ndikuar në drejtim të përmirësimit të shoqërisë (53,5%).

**7.** Sa i përket aktivizmit politik, të rinjtë janë më të prirur të «ndalojnë blerjen e gjërave për arsye politike apo mjedisore» (23,6%) dhe kanë qëndrimet më pozitive për këtë aktivitet (ende jo, por do të doja 14,9%).

**8.** Sa u përket institucioneve, të rinjtë tregojnë më shumë besim ndaj organizatave fetare ( $m=3,18$ ), ushtrisë ( $m=3,02$ ) dhe BE-së ( $m=2,71$ ), dhe veç kësaj besojnë se organizatat fetare kanë mjaftueshëm pushtet.

**9.** Për popullsinë e studiuar, vlerat më të rëndësishme janë të drejtat e njeriut, mirëqenia ekonomike e qytetarëve dhe siguria. Vlerat e përmendura, por edhe vlerat; demokracia, sundimi i së drejtës, punësimi, barazia gjinore dhe sociale dhe liritë individuale vlerësohen më lart në BE sesa në Maqedoninë e Veriut.

**10.** Qëndrimet e të rinjve ndaj hyrjes në BE janë të ndara, me 41,7% që mbështesin procesin dhe 37,9% që nuk e mbështesin atë. Qëndrimet janë gjithashtu të ndara kur bëhet fjalë për Propozimin francez. Euroskepticizmi duket se është në rritje, veçanërisht në mesin e popullsisë më të re, por ky proces nuk mund të shpjegohet plotësisht me kërkesat e kuadrit të ri negociues. Sipas rezultateve, kësaj çështjeje duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje në të ardhmen, por edhe të analizohet nga kënde të shumta.

**11.** Për herë të parë në kryerjen e studimeve longitudinale për të rinjtë që nga viti 2013, identifikimi me Evropën ka një vlerë mesatare prej më pak se 3. Të rinjtë që nuk mbështesin kuadrin negociues të propozuar nga Franca, kanë më pak gjasa të identifikohen si qytetarë të Evropës apo evropianë ( $r=-,325$ ,  $p<0,01$ ). Megjithkëtë, besimi në BE mbetet i pandryshuar nga Studimi për të rinjtë 2018/2019 ( $m=2,71$ , vs.  $m=2,72$ ).

**12.** Identifikimi me identitetin kombëtar gjithashtu ka rënë (nga m=4,12 në 2018/2019, në m=3,71).

**13.** Nga të anketuarit që janë punëtorë me kohë të plotë, vetëm 15,2% janë anëtarë të sindikatës.

**14.** Gati gjysma e të anketuarve mbështesin nismën e Projektligjit për barazinë gjinore.

**15.** Të rinjtë më së shumti u përgjigjën se nuk kanë kohë të ndjekin informacionet për politikën dhe ngjarjet aktuale në televizion, përfshirë përmbajtjet e prodhuara nga televizionet, të cilat gjenden online. Ndërsa edhe ata të rinj që ndjekin këto media zakonisht kalojnë rreth 1 orë në javë, më pak se 10 minuta në ditë.

## Rekomandime

**1.** Nevoja për arsimim politik të rinisë së vendit është një prioritet kyç. Është e nevojshme që të rinjtë të fitojnë njohuri rreth sistemit demokratik, rolit dhe detyrimeve të qytetarëve në një sistem të tillë, veçanërisht rreth mundësive për pjesëmarrje politike dhe ndikim në vendimet që i tangojnë ata.

**2.** Problemi i pozicionimit ideologjik të të rinjve tregon nevojën për arsim plotësues politik lidhur me ideologjitë e ndryshme dhe qasjen e tyre ndaj problemeve sociale. Në këtë mënyrë, të rinjve do t'u jepet mundësia të zgjedhin një ideologji të veçantë dhe partinë që përfaqëson ato qëndrime ideologjike, në mënyrë që ata të mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar në mënyrë më efektive.

**3.** Është e nevojshme që të rinjtë të përfshihen në proceset vendimmarrëse, veçanërisht në temat që i prekin ata drejtpërdrejt.

**4.** Partitë politike duhet të përfshijnë më shumë gra në pozita drejtuese dhe të investojnë në ndërtimin e barazisë gjinore brenda partive të tyre, në mënyrë që të rrisin besimin e grave dhe vajzave në politikë dhe kështu t'i motivojnë ato të angazhohen aktivisht në proceset politike.

**5.** Është e nevojshme që partitë politike, si dhe institucionet qeveritare, të bëjnë një përpjekje serioze për të kapërcyer problemet që lidhen me sundimin e së drejtës, korrupsionin, arsimin dhe sistemet shëndetësore dhe dobësitë e tjera në sistem, në mënyrë që të rivendoset besimi tek të rinjtë

**6.** Është e nevojshme të prezantohet një kulturë e re politike nga partitë politike në vend, e cila do të bazohet në dialogun konstruktiv, që do të parandalojë diskriminimin mbi baza politike

**7.** Është e nevojshme që sindikatat të gjejnë qasjen e duhur ndaj të rinjve dhe t'u ofrojnë atyre edukim në lidhje me të drejtat e punëtorëve dhe tregun e punës

**8.** Nëpërmjet futjes së lëndës së Edukimit Politik në shkollat e mesme, të rinjtë pritet të fitojnë njohuri<sup>7</sup> që do të rezultojnë në një interes më të madh për ndjekjen e politikës, një nivel më të madh të aktivizmit politik, njohje të proceseve politike dhe profilizimit ideologjik.

**9.** Është e nevojshme që shteti ti ndjekë gjendjet, prioritetet dhe interesat e gjeneratave të reja përmes studimeve (hulumtimeve) longitudinale mbi bazën e të cilave më tutje do të bazohen politikat dhe strategjitë shtetërore për të rinjtë.

# Referenca

- Amini, C.; Douarin, E. (2020): Corruption and life satisfaction in transition: is corruption a social norm in Eastern Europe? *Soc. Indic. Res.* 151, 723–766, → [link.springer.com/article/10.1007/s11205-020-02389-6](https://link.springer.com/article/10.1007/s11205-020-02389-6)
- Anderson, C.J.; Tverdova, Y.V. (2003): Corruption, political allegiances, and attitudes toward government in contemporary democracies. *Am. J. Polit. Sci.* 47, 91–109 → [onlinelibrary.wiley.com/doi/abs/10.1111/1540-5907.00007](https://onlinelibrary.wiley.com/doi/abs/10.1111/1540-5907.00007)
- Atanasov, P.; Naumovska, B. (2013): Equal opportunities of women: Processes of employment and promotion on higher positions. *Ekonomске Te Ekonomске Teme*, 51(4), 811–826.
- Bárta, O.; Boldt, G.; Lavizzari, A. (2021): Meaningful youth political participation in Europe: concepts, patterns and policy implications research study. Council of Europe and European Commission, → [pjp-eu.coe.int/documents/42128013/47261953/PREMS+149821+GBR+2600+Study+on+Youth+political+participation+WEB+16x24+%281%29.pdf/d2ecb223-edda-a9d2-30f7-c77692a086bd?t=1638984108000](https://pjp-eu.coe.int/documents/42128013/47261953/PREMS+149821+GBR+2600+Study+on+Youth+political+participation+WEB+16x24+%281%29.pdf/d2ecb223-edda-a9d2-30f7-c77692a086bd?t=1638984108000)
- Cordón, J.A.F. (1997): Youth residential independence and autonomy: A comparative study. *Journal of family issues*, 18(6), 576–607, shiko në → [journals.sagepub.com/doi/10.1177/019251397018006002](https://journals.sagepub.com/doi/10.1177/019251397018006002)
- Ellis, A.; Gratschew, M.; Pammett, J.H.; Thiessen, E. (et al.) (2006): Engaging the Electorate: Initiatives to Promote Voter Turnout from Around the World.
- Ermisch, J.; Di Salvo, P. (1997): The economic determinants of young people's household formation. *Economica*, 64(256), 627–644.
- European Commission, Directorate-General for Education, Youth, Sport and Culture, Education and training monitor 2021 – Education and well-being, Publications Office of the European Union (2021) → [data.europa.eu/doi/10.2766/743550](https://data.europa.eu/doi/10.2766/743550)
- Financing Our Future: How to Improve the Efficiency of Education Spending in North Macedonia (English)(2023) Washington, D.C.: World Bank Group → [documents.worldbank.org/curated/en/099611203072331625/IDU02747db220dccb04121085080c320d7f75d60](https://documents.worldbank.org/curated/en/099611203072331625/IDU02747db220dccb04121085080c320d7f75d60)
- Hague, R.; Harrop, M. (2007): *Comparative Government and Politics*. England: Palgrave Macmillan.
- Iacovou, M.; Aassve, A.; Davia, M. (2007): *Youth poverty in Europe*. York: Joseph Rowntree Foundation.
- Iacovou, M. (2010): Leaving home: Independence, togetherness and income. *Advances in life course research*, 15(4), 147–160.
- Lee, E.S. (1966): A theory of migration. *Demography*, 3, 47–57.
- Mallinson, D.J.; Hatemi, P.K. (2018): The effects of information and social conformity on opinion change. *PLoS one*, 13(5), e0196600.
- Massey, D.S.; Arango, J.; Hugo, G.; Kouaouci, A.; Pellegrino, A.; Taylor, J. E. (1993): Theories of international migration: A review and appraisal. *Population and development review*, 431–466.
- OECD (2022): *Labour Migration in the Western Balkans: Mapping Patterns, Addressing Challenges and Reaping Benefits*, available on *Labour Migration in the Western Balkans: Mapping Patterns, Addressing Challenges and Reaping Benefits* → [oecd.org](https://oecd.org)
- OECD Reviews of Evaluation and Assessment in Education: North Macedonia, *OECD Reviews of Evaluation and Assessment in Education* (2019), OECD Publishing, Paris → [doi.org/10.1787/079fe34c-en](https://doi.org/10.1787/079fe34c-en)
- Ostrom, T.M. (1969): The relationship between the affective, behavioral, and cognitive components of attitude. *Journal of experimental social psychology*, 5(1), 12–30.
- Pickard, S. (2019): *Politics, Protest and Young People: Political Participation and Dissent in 21st Century Britain*. London: Palgrave Macmillan
- Profile of child population in the Republic of North Macedonia: results of the analysis of data on children from the 2021 Census of Population, Households and Dwellings and administrative data (2023) UNICEF → [unicef.org/northmacedonia/media/14386/file/MK\\_CensusForChildren\\_Report\\_2024\\_ENG.pdf](https://unicef.org/northmacedonia/media/14386/file/MK_CensusForChildren_Report_2024_ENG.pdf)
- Robbins, S.P.; Judge, T. (2013): *Organizational Behavior*: Stephen P. Robbins, Timothy A. Judge. Pearson.
- Rokeach, M. (1973): *The nature of human values*. Free press.

- Schizzerotto, A.; Lucchini, M. (2004): Transitions to adulthood. In *Social Europe* (pp. 62–84). Edward Elgar Publishing.
- Sompolska-Rzechuła, A., & Kurdyś-Kujawska, A. (2022): Generation of young adults living with their parents in European Union countries. *Sustainability*, 14(7), 4272.
- Stojceska, B.; Dukovska, B.; Topuzovska Latkovikj, M. et al. (2024): Position of the NEET Youth in North Macedonia: Control study.
- Eisner, S. (2005): Generational Differences in the Workplace: Personal Values, Behaviors, and Popular Beliefs, *Journal of Business and Psychology*
- Twenge, J.M.; Campbell, S.M.; Hoffman, B.J.; Lance, C.E. (2010): Generational Differences in Work Values, Outcomes and Person-Organization Values Fit, *Journal of Management*
- Weiss, J. (2020): What is youth political participation? Literature review on youth political participation and political attitudes. *Frontiers in Political Science*, 2, 1.
- Employment Service Agency of the Republic of North Macedonia, Annual Reports, shiko në → [Годишни извештаи \(av.gov.mk\)](#)
- Agjencia për media dhe shërbime audivizuele (2014) Të rinjtë dhe mediat → [avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Magdalena.pdf](#)
- Agjencia për rini dhe sport e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2022): Hulumtim për trendet rinore shiko në → [api.ams.gov.mk/wp-content/uploads/2022/10/istrazhuvane-ams-2022.pdf](#)
- Галевски, М., Ивановиќ, И., & Јетковиќ Јанева, Ј. (2022): Социо-политичко учество на младите во Северна Македонија: Лет во место. Westminster Foundation for Democracy, North Macedonia, → <https://www.wfd.org/sites/default/files/2024-02/WFD%20Let%20vo%20mesto%20Socio%20politicko%20ucestvo%20na%20mladi%20ZA%20WEB.pdf>
- Ѓорѓиовска, Ј., & Галевски, М. (2021): Социо-политичко учество на младите во Северна Македонија: Нееднаквост, неизвесност и различни очекувања. Фондација за демократија на Вестминстер, Северна Македонија → [wfd.org/sites/default/files/2022-02/Socio-Politicko%20Ucestvo%20na%20mladite%202021%20MK%20%5Bsmweb%5D%20%281%29.pdf](#)
- Дамјановски, И., (2023): Анализа на јавното мислење за македонскиот процес за пристапување кон ЕУ (2014–2023). Скопје: Фондација Конрад Аденауер и Институт за демократија, → [ids.org.mk/wp-content/uploads/2023/12/B5-Public-Opinion-Analysis-Paper-No.-27-2023-WEB.pdf](#)
- Enti shtetëror për statistikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2024): Arsimi dhe shkencë 2022/2023
- Statistikat shtetërore për Republikën e Maqedonisë së Veriut, shih Popullsia e përgjithshme rezidente në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas grupmoshave 5-vjeçare dhe sipas gjinisë, sipas komunave, Regjistrimi 2021. PxWeb → [stat.gov.mk](#)
- Enti shtetëror për statistikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i disponueshëm për natalitetin në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2023 – të dhëna përfundimtare → [stat.gov.mk](#)
- Enti shtetëror për statistikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i disponueshëm për Familjet sipas përbërjes, numrit të anëtarëve dhe llojit të vendbanimeve, sipas komunave, Regjistrimi 2021. PxWeb → [stat.gov.mk](#)
- Komisioni shtetëror i zgjedhjeve iVote DEMOKRA – Sistemi i integruar informativ zgjedhor i Komisionit shtetëror të zgjedhjeve (sek.mk) Евротинк (2023) Перцепции и ставови на граѓаните на Република Северна Македонија за општествено-политичката состојба во државата, информирање и евроинтегративните процеси, shiko në → [www.sec.mk](#)
- Малески, Б., & Барлаковски, П. (2023): Млади на попис: Анализа на податоците од пописот на населението, домаќинствата и становите од 2021 година кои се однесуваат на младите. Фондација за демократија на Вестминстер, Република Северна Македонија → [wfd.org/sites/default/files/2024-02/web%20Mladi%20na%20popis\\_so%20finalen%20tekst\\_02\\_so%20korekcii\\_preview.pdf](#)
- Малески, Б., & Барлаковски, П. (2023): Млади на попис: Анализа на податоците од пописот на населението, домаќинствата и становите од 2021 година кои се однесуваат на младите. Westminster Foundation for Democracy, North Macedonia, → [wfd.org/sites/default/files/2024-02/web%20-%20Mladi%20na%20popis\\_so%20finalen%20tekst\\_02\\_so%20korekcii\\_preview.pdf](#)

# Fusnota

Михајлов, А. (2020): Справување со повеќекратна дискриминација кај ЛГБТИ+ Роми. Здружение за сексуални и родови малцинства Субверзивен ФРОНТ Скопје, → [s-front.org.mk/wp-content/uploads/2020/12/vodich-za-povekjekratna-diskriminacija-kaj-lgbti-romi.pdf](https://s-front.org.mk/wp-content/uploads/2020/12/vodich-za-povekjekratna-diskriminacija-kaj-lgbti-romi.pdf)

Наумовска, Б. и други (2022): Политичко-правните и културолошки предизвици во справувањето со пандемијата. Скопје: Институт за социолошки и политичко-правни истражувања

Наумовска Б. И други (2022): Изборниот систем на РСМ: Како да се обезбеди рамноправна и фер застапеност во Собранието, Национален демократски институт

Податоци ЕОИ за Македонија, 10ти бран, 2022. → [isppi.ukim.edu.mk/sites/default/files/2023-03/4.-naumovska-uchestvo-na-graganite-vo-politikata.pdf](https://isppi.ukim.edu.mk/sites/default/files/2023-03/4.-naumovska-uchestvo-na-graganite-vo-politikata.pdf)  
→ [europeansocialsurvey.org](https://europeansocialsurvey.org)

Стојановски, К. (2016): Дискриминација, насилство и малтретирање врз основа на сексуална ориентација, → [Извештај-од-истражувањето-за-дискриминација-насилство-и-малтретирање-врз-основа-на-сексуална-ориентација-и-родов-идентитет-1.pdf](#)

Топузовска Латковиќ, М., Борота Поповска М., Серафимовска, Е., Цекиќ, А. (2013): Студија за младите во република Македонија 2013. Скопје: Фондација Фридрих Еберт → [collections.fes.de/publikationen/content/titleinfo/454846](https://collections.fes.de/publikationen/content/titleinfo/454846)

Топузовска Латковиќ, М., Борота Поповска М., Серафимовска, Е., Цекиќ, А., Старова, Н. (2019): Студија за млади во Северна Македонија 2018/2019. Скопје: Фондација Фридрих Еберт → [library.fes.de/pdf-files/bueros/skopje/15292.pdf](https://library.fes.de/pdf-files/bueros/skopje/15292.pdf)

Топузовска Латковиќ, М., Борота Поповска М., Чупеска, А., Старова Н., Ѓорѓев, Д. (2021): Студија за жените во република Северна Македонија 2020/2021. Скопје: Фондација Фридрих Еберт → [library.fes.de/pdf-files/bueros/skopje/17556-20210318.pdf](https://library.fes.de/pdf-files/bueros/skopje/17556-20210318.pdf)

- 1 Тë cilët nuk janë të punësuar, e as të përfshirë në arsim ose trajnime (ang. Not in Education, Employment, or Training).
- 2 Arsimi fillor në vitin 2015 u ndoq nga 194,000 nxënës, ndërsa arsimi i mesëm në vitin 2015 u ndoq nga 76,000 nxënës. ESHS
- 3 Shih kapitullin »Qëndrimet politike dhe pjesëmarrja politike«
- 4 Zgjedhjet u shpallën më 14 shkurt, fushata për zgjedhjet parlamentare filloi më 18 prill dhe zgjedhjet u mbajtën më 8 maj 2024.
- 5 Instrumenti është krijuar në gjysmën e parë të vitit 2023, kur u përcaktuan subjektet më të rëndësishme politike. Sondazhi është realizuar në vitin 2024 kur ndodhën ndarjet në partinë Aleanca për Shqiptarët, që mund të ketë patur ndikim në përgjigjet e të anketuarve, në atë mënyrë që të mos dinë saktësisht se për kë të shprehin qëndrimin e tyre.
- 6 Përmes futjes së kësaj lënde në shkollat e mesme, të rinjtë pritet të fitojnë njohuri se si të vlerësojnë proceset politike, cili është roli i tyre si qytetarë, çfarë do të thotë ideologji dhe sa është e pranishme e njëjta, çfarë do të thotë sovraniteti shtetëror, kujt i përket dhe si përcillet, ta kuptojnë vendosjen e sistemit politik dhe partiak, ndarjen e pushtetit etj. Përveç asaj që u përmend, kjo njohuri duhet të rezultojë edhe në drejtim të njohjes së proceseve politike, profilizimin ideologjik, pavarësinë në marrjen e vendimit gjatë zgjedhjeve por edhe kuptimin e thelbit të politikës e cila duhet të jetë me interes për qytetarët dhe shoqërinë.
- 7 Nxënësit duhet të fitojnë gjithashtu njohuri: si të vlerësojnë proceset politike, cili është roli i tyre si qytetarë dhe cilat mekanizma kontrolli mund të përdorin, çfarë do të thotë ideologji dhe sa është ajo e pranishme, çfarë do të thotë sovraniteti, kujt i përket dhe si përcillet, ta kuptojnë vendosjen e sistemit politik dhe partiak, ndarjen e pushtetit etj.



# Figurat

- 12 **Fig. 1** Shpërndarja e popullsisë së re sipas gjinisë dhe moshës
- 12 **Fig. 2** Përshkrimi i mostrës (in %)
- 14 **Fig. 3** Kënaqësia me cilësinë e arsimit mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)
- 15 **Fig. 4** Perceptimi i korrupsionit në arsim mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)
- 16 **Fig. 5** Orët e kaluara në të nxënit mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)
- 16 **Fig. 6** Adaptimi i kurikulave arsimore në botën e punës – mendimet mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)
- 17 **Fig. 7** Përshtatja e arsimit dhe punësimit mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)
- 18 **Fig. 8** Sektori i preferuar i punësimit mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)
- 19 **Fig. 9** Renditja e faktorëve të rëndësishëm për zgjedhjen e punës
- 19 **Fig. 10** Renditja e faktorëve për gjetjen e punës
- 23 **Fig. 11** Dëshira për emigrim mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)
- 25 **Fig. 12** Dëshira për emigrim mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut, sipas vendit
- 26 **Fig. 13** Arsyet kryesore për emigrim mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)
- 29 **Fig. 14** Të rinjtë dhe (pavarësia) e banimit (in %)
- 32 **Fig. 15** Vlerat më të rëndësishme për të rinjtë në Maqedoninë e Veriut
- 34 **Fig. 16** Frikat dhe shqetësimet mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut
- 36 **Fig. 17** Qëndrimet ndaj të drejtave të pakicave mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)
- 37 **Fig. 18** Mendimet shoqërore mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut
- 42 **Fig. 19** Përfaqësimi i interesave të të rinjve në politikë (in %)
- 42 **Fig. 20** Pozicionimi ideologjik mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)
- 43 **Fig. 21** Qëndrimet e definuara ideologjikisht mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut
- 45 **Fig. 22** Ndjenjat ndaj partive politike mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut
- 46 **Fig. 23** Besimi në institucione mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut
- 48 **Fig. 24** Vlerat demokratike kundrejt autoritare mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut (in %)
- 49 **Fig. 25** Vlerat më të rëndësishme për të rinjtë në Maqedoninë e Veriut (in %)
- 50 **Fig. 26** Gjendja e perceptuar e vlerave në vendin e tyre dhe në BE mes të rinjve në Maqedoninë e Veriut

## Për Autorët

**Marija Topuzovska Latkovikj** është profesoreshë e rregullt e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe metodologjisë hulumtuese në biznes dhe menaxhment, në Institutin për hulumtime sociologjike dhe juridiko-politike, Universiteti «Shën Kirili dhe Metodi» në Shkup. Interesi kryesor hulumtues i saj është kryesisht i fokusuar te të rinjtë, qëndrimet dhe vlerat e tyre të punës; preferencat, perspektivat dhe barrierat për arsimim, punësimi dhe ngritja në detyrë; mobiliteti dhe migrimi. Autore e disa studimeve për të rinjtë në shtet dhe rajon, si dhe e publikimeve të tjera të temave të shkencave shoqërore dhe menaxhimit.

**Mirjana Borota Popovska** është profesoreshë e rregullt e më shumë lëndëve të fushës së biznesit dhe menaxhmentit në Institutin për hulumtime sociologjike dhe juridiko-politike, Universiteti «Shën Kirili dhe Metodi», Shkup. Gjatë eksperiencës 30-vjeçare të punës në Institutin për hulumtime sociologjike dhe juridiko-politike ka marrë pjesë në më shumë se 50 projekte shkencore dhe aplikative në fusha të ndryshme të shkencave shoqërore.

**Bojana Naumovska** është profesoreshë e rregullt në fushën shkencore mësimore sisteme zgjedhore, në Institutin për hulumtime sociologjike dhe juridiko-politike, Universiteti «Shën Kirili dhe Metodi» në Shkup. Interesi i saj hulumtues është i drejtuar drejt sistemeve zgjedhore dhe partive politike, edhe pse hulumton dhe fusha të tjera të shkencave politike. Është bashkautore e një sërë studimeve hulumtuese dhe profesionale.

**Nita Starova** është menaxhere e programit në Fondacionin Fridrih Ebert – zyra Shkup dhe magjistre në marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci. Gjatë përvojës së punës, ka realizuar një sërë projektesh në fushën e arsimit politik, sigurisë dhe barazisë gjinore, si dhe projekte hulumtuese me fokus gratë dhe femrat.

## **Imprint**

### **Editor & Publisher**

Friedrich-Ebert-Stiftung Skopje  
Boul. 8-mi Septemvri 2/2-5  
(TCC Grand Plaza), Skopje 1000  
North Macedonia

### **Responsible for Content**

Dr. Peter Hurrelbrink, Director  
Friedrich-Ebert-Stiftung Skopje  
Tel.: +389 230 93-181  
skopje.fes.de

### **Youth Study North Macedonia 2024**

Project Coordinator: Nita Starova, FES Skopje  
Translation: Natasha Kolekevaska Georgievska  
Proofreading: Anrew Goodspeed

### **Youth Study Series 2024**

*FES Democracy of the Future – Vienna*

Director: Johanna Lutz

Lead Researcher: Elena Avramovska

Editing Coordinator and Communication

Europe: Margarete Lengger

Project Management: Krisztina Stefán

*FES South-East Europe – Sarajevo*

Project Management: Saša Vasić

Communication SOE: Ema Džejna Smolo-Zukan

### **Orders / Contact**

contact@fes-skopje.org

### **Design Concept**

René Andritsch & Heidrun Kogler

### **Layout**

4S Design

Commercial use of all media published by the Friedrich-Ebert-Stiftung (FES) is not permitted without the written consent of the FES. The views expressed in this publication are not necessarily those of the Friedrich-Ebert-Stiftung or of the organization for which the author works.

**Skroni kodin  
dhe lexoni online:**

